



**ALBANIAN THIRD POSITION**



# Interpretimi Tradicionalist i Skenderbeut

The Traditional Interpretation of Skanderbeg



Interpretimi Tradicionalist i Skenderbeut  
The Traditional Interpretation of Skanderbeg

© ALBANIAN THIRD POSITION ©

-2020-

# -Permbajtja-

Parathenie ..... 4

Hyrje..... 7

## Pjesa e I: Simbolet

Ikonografia me e vjeter e armeve te Skenderbeut..... 25

Kreshta ne formen e dhise ..... 28

Briret dhe natyra e tyre ..... 32

Shqiponja dykrenare dhe miti i dy zogjve..... 36

Ngjyrat e shenjta te indo-evropianeve ..... 41

## Pjesa e 2: Legjenda

Skenderbeu dhe miti i birit te vejushes..... 44

Gjuha e zogjve dhe bijte e shqiponjes..... 51

Qendra tradicionale e Dodones,Mbreti Artur dhe Skenderbeu56

Skenderbeu, perandori i shenjte..... 63

Vdekja e Skenderbeut..... 69

Perfundimi..... 73

# -Content-

Foreword .....	77
Introduction .....	80
<u>Part I: Symbols</u>	
The oldest iconography of Skanderbeg's regalia .....	99
The goat Crest .....	102
The horns and their nature.....	106
The double headed eagle and the myth of the two birds.....	110
The sacred Colors of Indo-Europeans .....	115
<u>Part 2: Legend</u>	
Skanderbeg and the myth of the widows son.....	118
The language of the birds and the sons of the eagle.....	125
Traditional center of Dodona, King Artur and Skanderbeg ..	130
Skanderbeg Imperator .....	137
The death of Skanderbeg.....	144
Conclusion .....	148

"Cdo njeri mban ne vete nje tradite qe e ben te jete ate qe eshte. Tradita eshte nje zgjedhje, nje peshperitje si nga kohet e lashta ashtu edhe nga e ardhmja. Me thote se nga e kam origjinen."

Dominique Venner, *Le Coeur Rebelle*

# Parathenie

Kjo pune eshte rezultati i nje ndjenje te brendshme urgjente. Ne nje bote moderne qe vazhdon te humbase kontaktin me realitetet me te larta dhe te vertetat e perjetshme, qe vazhdon te kerkoje lehtesi dhe te shmange cdo lloj pergjegjesie, qe preferon jeten e nje skllavi ne vend te jetes se nje luani sepse kjo e fundit mund te humbase papritmas, nuk eshte habi qe nje personazh si Skenderbeu i shqeteson bashkekohesit tane. Nga te ashtuquajturit shqiptare qe bejne shqiponjen me duar dhe harrojne qe atdheu ka nevoja te tjera, tek ata skizofrene qe e mohojne ate si hero (qe me shqiptaret e vertete kane te perbashket vetem gjuhen), tek politikane qe duhet te kuptojne domethenien e dhurates se Skenderbeut ndaj renegatit Ballaban Pasha: nje shkop druri per t'i kujtuar qe ai nuk ka te drejte te udheheqe askend e deri ne fund tek ata qe kane sindrome Stokholmi dhe promovojne miqesi te perjetshme me babain e armiqve te betuar te vendit. Cfare eshte me rendesi nuk eshte situata e tanishme diplomatike ne gadishullin Ballkanik. Cka ka rendesi eshte te dallojme trendet metafizike te historise te perfaqesuar nga cdo komb dhe perandori, te jesh ne dijeni se ku qendron ne relate me to dhe se ku duhet te qendrosh. Me pak fjale, eshte te pershtatesh me Traditen tende.

Ka nje urgjence per kulturen shqiptare te adaptoje nje kuptim Tradicional te epikes se Gjergj Kastriot Skenderbeut. Me te vertete, pa nje pike te thelle reference, nje yll polar, kultura jone do te jete perjetesisht ne duart e rrymave te jashtme. Vetem Gjergj Kastriot Skenderbeu mund te na jape kete pike te palekundur reference per te gjithë shqiptaret e vertete. Kjo pune eshte nje mbledhje modeste artikujsh qe perpiqen te japin kete pike reference. Artikujt jane publikuar online nga tetori 2019 deri ne janar 2020 dhe jane perpunuar perseri qe te permblidhen me mire ketu. Jane produkti i patrioteve qe i perkasin nje kohe tjetër, qe i ka ardhur ne maje te hundes me boten moderne por kane deshire te permbushin fatin dhe detyren e tyre si shqiptare pavaresisht cdo gjeje. Ky studim i temave ezoterike te Skenderbeut eshte gjithashtu rezultati i nje intuitede intelektuale qe na ka bere pune shpeshhere.

Ne shpresojme qe kjo pune do te sjelle nje baze per investigime me te thella tradicionale rreth heroit tone dhe do te shkaktoje studime te tjera tradicionale qe kane te bejne me prejardhjen tone ilire, Shqiperine mesjetare dhe botekuptimin e malesoreve. Kuptimi tradicionalist i ezotericizmit te Skenderbeut mund te veproje si nje burim rifreskues per identitetin tone: kombinimi i memorjes tone me te lashte evropiane me shprehjen tone te miteve rreth heroit tone te cilat reflektojne Traditen Pereniale. Me te vertete, kur burime e pershtatshme tradicionale te nje populli sillen ne jete ne menyren e sakte, perspektiva te reja politike mund

te lindin brenda atyre qe i bejne keto investigime, dhe Shqiperia dhe shqiptaret mund te shijojne rikthimin e nje epoke te arte qe do te perfshije dhe Evropën.

Ky kerkim, i ngjashem me kerkimin e Graalit legjendar, ne menyre per te rifituar ate cka duket perfundimisht e humbur mund te filloje vetem nepermjet Gjergj Kastriot Skenderbeut, dhe vetem me ndihmen e tij dikush mund ta ndermarre ate. Pa dyshim qe miq te panjohur nga ana tjeter e lumit qe ndan boten fizike profane nga mbreteria metafizike e zotave do te vijne ne ndihmen tone.

Kjo pune i dedikohet te gjithe shqiptareve te vertete, jetofshin ne atdhe apo jashte. I dedikohet gjithashtu memorjes dhe shpirtit te heroit tone kombetar, Gjergj Kastriot Skenderbeut.



# Hyrje

"Vetem rikthimi i shpirtit Tradicional mund ta shpetoje Evropën."

-Julius Evola-

- Shqiperia dhe Tradita

Shqiptaret e shek. të 21 e gjejnë veten në një krizë të thellë identiteti. Asnjë komb evropian nuk është i kursyer nga kjo krizë, por në rastin e Shqipërisë ka disa elemente më shumë që veprojnë, si emigracioni i lartë, politikane të korruptuar ish-komuniste dhe trashëgimtarët e tyre dhe lidhjet diplomatike të dyshimta. Materializmi i përhapur duhet përmendur gjithashtu. Sidomos në format kanosëse të Liberalizmit banal dhe hegjemonisë të shkollareve të Marksizmit në botën e sotme kulturore. Me të vërtetë, kultura ka rëndësi të madhe në një shoqëri, pasi përcakton vlerat dhe ligjet e brendshme të shenjtë të një kombi. Liberalizmi, i cili vlerëson kënaqësinë vetjake të menjehershme dhe promovon ndarjen e individit nga rrenjet e tij; nga ana tjetër Marksizmi ka shkateruar kuptimin e historisë së Shqipërisë jashtëzakonisht shumë në mënyrë që të vazhdojë krizën e identitetit, dhe keto

rryma kontrollojne kulturen e Shqiperise. Liberalizmi dhe Marksizmi jane dy anet e te njejtës monedhe subversive dhe nuk eshte habi qe jane dy shtizat e subversionit qe i jane ngulur trupit te identitetit shqiptar. Por nuk duhen harruar efektet negative te feve.

Lidhjet fetare qe bejne sikur jane te vetmet tradita te vlefshme, thjesht e shtojne konfuzionin. Ne fakt, nje qendrim skizofren ka lindur kohet e fundit qe e ka bere shqiptarin te marre zakone dhe menyra sjelljesh te pazakonta per ne, keto te frymezuara nga lidhjet fetare. Kjo mund te habise disa lexues, qe i shohin fete si elemente qendrore ne formimin e identitetit kombetar. Po per shqiptarin qe e ka ndare gjithnje etnine nga feja, kjo gje eshte tejet e panatyrshme, sidomos kur mendon se shqiptari e ka bazuar identitetin gjithnje ke etnia. Disa individe shkojne deri ne piken ku thone qe vetem fete mund ta lidhin Shqiperine me kultura me te larta. Ky kendveshtrim vjen nga besimi qe Shqiperia nuk ka tradite te veten dhe nga ideja e ex oriente lux: qe drita shpirterore vjen vetem nga lindja. Keto elemente shkaktojne nje ndjenje boshlleku ke shqiptaret.

Duket sikur subversioni modern thjesht po mban nje krize identiteti qe ka qene aty me pare, dhe e ka kthyer ne nje boshllek identiteti. Pa dyshim, kriza ka filluar me regjimin komunist te Enver Hoxhes, i cili shkaterroi shume pjese te traditave te lashta, pasi i shihte si te pavlera. Ketu kemi nje piketakim mes subversionit te paster dhe feve monoteiste nga shkretetira. Te dyja

bien ne perfundimin qe shqiptaret duhet te jene proletariane apo besimtare mbi te gjitha. Fakti qe feja po lind mes shqiptareve ne menyra te papara me pare eshte prove qe ky boshllek po mbushet nga dicka, ashtu si komunizmi e mbushi ne te kaluaren. Ky boshllek duhet te mbushet patjeter, por jo me elemente te papershtatshme. Perpara ketyre koheve, Shqiperia ka qene nje nga vendet e pakta ne bote, dhe patjeter i fundit ne Evrope, qe ka jetuar sipas kultures dhe principeve tradicionale. Zhdukja e Tradites duhet te kete te beje me arsyen per boshllekun identitar. Por Tradita e permendur ketu nuk ka te beje fare me fete prezente ne Shqiperi.

Tradita te ciles po i referohemi eshte Tradita Pereniale e percaktuar nga Rene Guenon dhe Julius Evola. Quhet Pereniale sepse parimet baze te saj jane te njejtat, pavaresisht ndryshimeve siperfaqesore mes shprehive te ndryshme historike. Ky nocion pranon idene qe nje force metafizike e cila duket here pas here ka vepruar ne periudha te caktuara historike tek popuj te ndryshem, duke i orientuar shoqerite te ashtuquajtura tradicionale te rrotullohen drejt asaj cka eshte me shume se njerezore. Norma dhe vlera te pandryshuara metafizike jane pikat e references per gjithë shoqerine dhe organizimin e saj. Detyra per te tejcuar Traditen bie mbi ata ne maje te sistemit hierarkik, qofte ai nje monark apo nje rend, i cili ka pushtet temporal (politik) dhe shpirteror ne te njejten kohe (pasja e pushtetit shpirteror eshte justifikimi per te patur pushtet temporal). Pra, Tradita eshte nje

prezence jetesore qe tejcohet, pavaresisht detajeve historike, permes iniciacioneve dhe simboleve.

Tradita Pereniale eshte e kunderta e botes moderne e cila eshte e karakterizuar nga mohimi i asaj cka eshte pertej njerezores, mohimi i hierarkise, theksi qe ve mbi arritjet materiale dhe relativizmin. Per te mos permendur besimin e verber tek progresi i pafundem. Pra, Liberalizmi dhe Marksizmi jane vetem shembuj te doktrinave anti-tradicionale. Fakti qe njera duket si pjese e te shkuares kurse tjetra eshte e te tashmes eshte dicka pa shume rendesi. Ato jane orientime te ndryshme qe mund te lindin ne cdo periudhe historike. Duke mos patur asgje te perbashket shpirtore, eshte me rendesi te jemi ne gjendje t'i dallojme ato dhe rrymat e tyre te ndryshme.

Perandorite, kombet dhe fete jane rryma te tilla qe dalin ne histori, dhe trendet metafizike qe qendrojne pas tyre dhe siper tyre duhen analizuar gjithashtu. T'i marresh ato ne konsiderate eshte te jesh ne dijeni te pozicionit qe ke kundrejt tyre dhe se ku duhet te qendrosh. Me pak fjale, duhet te gjesh se ne cilen tradite pershtatesh. Ashtu si dikush lind ne nje trup specifik dhe race specifike me nje shpirt specifik, pa mundesine per ta kembyer per nje tjetër, pra duke qene pjese e nje familjeje me te gjere, e njejta gje vlen dhe per traditat. Gjithsekushi eshte i lidhur me nje tradite, ajo vete eshte pjese e nje familjeje me te gjere traditash. Te perpiqesh te ndryshosh traditen eshte te kembesh harmonine me te kunderten e saj, ate cka pershtatet me ate cka nuk pershtatet.

Pra, Shqipëria duhet të ketë një traditë të caktuar, pjesë e një familjeje me të gjera traditash, e cila përshtatet me shqiptarin. Tradita shqiptare është e lidhur aq shumë me identitetin, dhe shqiptari duhet të shkojë ke rrenja e saj dhe të mesojë me shumë për parimet metafizike të kësaj tradite shqiptare. Tek rrenjet e identitetit shqiptar, gjejme Gjergj Kastriot Skenderbeun.

- Legjenda e Gjergj Kastriot Skenderbeut

Gjergj Kastriot Skenderbeu është personazhi më i lartë i historisë shqiptare, ai përcaktoi identitetin shqiptar në një pikë kyçe në histori. Ky princ i shekullit të 15 është një figurë e mirënjohur në Evropë ku shumë libra janë shkruar për të nderuar suksesin e tij epik kundër Perandorisë Osmane. Shumica e këtyre librave nuk janë shkruajtur në shqip, por në gjuhë të tjera. Ateher, ashtu si dhe sot, të huaj (Sllavet) u përpoqën ta bënin Skenderbeun të vetin, dikë që prifti shqiptar Frang Bardhi e kundërshtoi. Ai deklaroi se shqiptarët e ruajtën Skenderbeun organikisht në gojedhena, kurse sllavet e ruajtën në mënyra artificiale pseudo-historike prej intelektualësh gjenshtarë. Pra, miti dhe përrallat popullore mbi Skenderbeun përcaktojnë identitetin shqiptar, ashtu si identiteti shqiptar përcaktohet nga vete Skenderbeu. Kjo nderlidhje është me të vërtetë e jashtëzakonshme dhe duhet të na shtyjë të konsiderojmë studimin e asaj çka do quajmë që tani si legjenda e Skenderbeut.

Legjenda eshte si vijon:

Ne Shqiperine mesjetare, Gjon Kastrioti, nje lord i fuqishem i Shqiperise se mesme humbi luften kunder Sulltanit te Perandorise Osmane. I mposhtur, ai tani eshte i detyruar te jete vasal i turqve dhe te coje 4 bijte e tij si pengje, perfshire ketu dhe Gjergjin e ri. Para lindjes se Gjergjit, mamaja e tij pa nje enderr ku ajo po lindte nje dragua, qe e ktheu koken nga Anadolli dhe bishtin nga Italia, kurse trupi rri ne Shqiperi. Bijte e Gjonit ikin nga keshtjella e te atit ne malet e Shqiperise per tek pallati i Sulltanit, ku ata sterviten si ushtare dhe konvertohen ne Islam me perdhune. Gjergji i ri, duke qene se ishte me i afti, merr gjithnje e me shume pergjegjesi ushtarake, kurse vellezerit e tij helmohen te gjithe. Gjergji, tani i njohur nen emrin islamik si Iskender (perkthyer: Aleksander), behet luftetar aq i mire, sa pranohet tek roja elitare e Sulltanit; jeniceret. Iskenderi vazhdon ngritjen e tij ne karriere, behet mik me Sulltanin dhe i jepet komanda e ushtrise osmane. Sukseset e tij ushtarake i japin titullin bej, qe do te thote lord ne turqisht. Pra, ai krahasohet me Aleksandrin e Madh.

Kur i mberrin lajmi per vdekjen e te atit, ai vendos te dezertoje nga ushtria osmane. Disa versione thone qe babai i tij u vra nen urdhrat e vete Sulltanit qe t'i merrte tokat dhe ta mbante Iskenderin si skllav. Bashke me nipin e tij dhe 300 luftetare shqiptare ne ushtrine osmane, Iskenderi braktis betejen e Nishit ndersa turqit luftojne kunder hungarezeve. Ata shkojne ne Shqiperi tek keshtjella te atit e cila ruhet nga nje guvernator turk.

Fale nje dokumenti te falsifikuar, Iskenderi e mashtron guvernatorin dhe e ben te mendoje se Sulltani ka dhene urdher qe ai te jete guvernatori i ri. Gjate nates, ai vret ushtaret turq aty, braktis Islamin dhe ngre flamurin e familjes (nje shqiponje e zeze me dy krena ne nje fushe te kuqe) siper keshtjelles. Ky akt do te thote lufte totale kunder Perandorise Osmane. Me vone mamaja i jep Skenderbeut shpaten e te atit.

Me pas ai cliron keshtjella te tjera ne Shqiperi dhe rekruton nje ushtri per te pergatitur veten kunder trupave osmane. Gjergji organizon nje mbledhje te lordeve shqiptare per t'i bashkuar kunder armikut te perbashket. Lordet bashkohen tek Lidhja e Lezhes dhe deklarojne Skenderbeun si liderin e tyre, i pari mes te barabarteve. Lidhja nen Skenderbeun e mposht ushtrine osmane qe erdhi ne Shqiperi. Kombi i vogel i Shqiperise kapi vemendjen e botes se Krishtere me kete fitore te papritur. Ky poshterim ishte i pagelltitshem nga Sulltani dhe ai vendos te udheheqe nje ushtri drejt keshtjelles se Skenderbeut dhe ta ndeshkoje personalisht. Sulltani e rrethon keshtjellen, por nuk e merr dot, dhe ushtria e tij humbet shume beteja kunder Skenderbeut. Edhe pse ka ushtri te vogel, Sknderbeu e tregon veten me te forte e me te zgjuar se turqit ne fushebeteje. Per shembull, njehere ai perdor nje tufe dhensh qe i ka lidhur pishtare te ndezur ne briret e tyre dhe sulmon gjate nates, duke i bere turqit te mendojne qe shqiptaret jane shume me shume ne numer dhe i masakron fale trullosjes. I

poshteruar keqazi per te dyten here, Sulltani e le rrethimin dhe vdes nen muret e keshtjelles se Skenderbeut.

Lufta vazhdon per shume vite. Edhe pse Skenderbeu adhurohet ne Evrope, asnje lloj ndihme nuk i jepet nga Evropa. Pavaresisht kesaj, ushtrite osmane vazhdojne te humbasin beteja ne Shqiperi. Duke i premtuar nipit te Skenderbeut ta bejne lord te Shqiperise, turqit e bindin te nderroje krahun, te kthehet ne Islam dhe t'i shpalle lufte Skenderbeut. Nipi perballet me xhaxhane, por vritet nga Skenderbeu ne dyluftim.

Skenderbeu, i pamposhtur ne Shqiperi, shkon me vone ne Itali te ndihmoje mbretin e Napolit kunder banditeve qe kerkojne t'i marrin fronin. Mbreti i Napolit eshte biri i mbretit te Aragonit, i cili ka vdekur dhe ishte mik i Skenderbeut. Ai thyen armiqte e mbretit dhe kthehet ne Shqiperi pasi demonstron shpirtin e tij kalorsiak. Ndersa ne Itali, Papa i njeh fitoret e Skenderbeut kunder osmaneve si hyjnore dhe pranon qe po mbrojne Krishterimin. Pra, ai i jep Skenderbeut titullin Athleta Christi.

Thuhet qe Skenderbeu ka kryer vepra te jashtezakonshme gjate viteve, ai arrin te ndaloje rrjedhen e nje lumi vetem me kembe, can male ne dysh me shpate, asnje ushtri nuk e kap dot pasi leviz shume shpejt neper Shqiperi, forca e tij eshte e jashtezakonshme etj. Shume gjenerale osmane dhe renegate shqiptare si Ballaban Pasha perballen Skenderbeun por te gjitha mposhten dhe vriten. Skenderbeu eshte i pamposhtur gjer ne vdekje.



Para se te vdese, keshilla e tij per shqiptaret eshte te qendrojne te bashkuar. Ai perdor shembullin e nje shkopi druri qe thyhet lehte nga nje femije, po kur shume shkopinj te vegjel bashkohen, as burrat me te forte nuk i thyejne dot. Nje dite, engjelli i Vdekjes duket mbi te, por Skenderbeu nxjerr shpaten dhe gatitet te luftoje. Pavaresisht kesaj, ai e kupton qe eshte koha e tij dhe i jep keshillen e fundit trashegimtarit te tij: te shkoje ne breg te detit dhe te gjeje nje peme selvie dhe te lidhe aty kalin, flamurin dhe shpaten.

Edhe pse eshte shume plak per te marre pjese ne betejea, Skenderbeu dhe reputacioni i tij i tmerrojne turqit. Kjo e mbron Shqiperine nga pushtime te tjera per ca kohe pas vdekjes se tij. Ai varroset ne katedralen e Lezhes. Turqit mesojne per vdekjen e armikut te tyre me te madh dhe gezojne se Evropa eshte e hapur per ta. Ata pushtojne Shqiperine dhe hapin varrin e Skenderbeut per t'i bere kockat e tij ne varese magjike qe tu japin fitore ne beteje. Por Perandoria Osmane deshton ne pushtimin e Evropes. Ne fakt, Skenderbeu i dha kohe Evropes te pergatitet.

Por do te na mungonte nje element i rendesishem nese nuk do te shtonim nje perralle popullore:

Skenderbeu paraqitet si nje burre gjigant me nje force te papare. Shpata e tij eshte aq e rende sa askush pervec tij nuk e ngre dot, dhe ndonjehere perceptohet si magjike. Ai ka nje helmete me koken e nje dhie per te celebruar fitoren e tij ndaj turqve. Flamuri

i tij eshte nje shqiponje me dy krena ne nje fushe te kuqe, qe pershtatet me emrin e shqiptareve, 'bijte e shqiponjes'.

Duke marre parasysh keto elemente, eshte e rendesishme te mesojme nga ato per traditen shqiptare tek rrenja e identitetit shqiptar. Vetem permes Gjergj Kastriot Skenderbeut dhe legjendes se tij mund ta ndermarrim kete kerkim, por duhet te bejme kujdes me metodologjine qe do te perdorim. Studimet mbi Skenderbeun jane rritur kohet e fundit. Cka eshte me rendesi eshte shpirti pas tyre. Asnje studim akademik, me adhurimin e tyre bosh te intelektualizmit dhe kritikes nuk mund te na jape nje pergjigje te kenaqshme me problemin qe kemi, sepse keto studime behen sipas tekave te metodes akademike moderne. Nga ana tjetere, nje studim duke ndjekur metoden Tradicionale te krijuar nga Rene Guenon dhe Julius Evola do te ishte i pranueshem per ate cka po perpiqemi te bejme ketu.

- Metoda Tradicionale

Studiuesit perqendrohen ke Skenderbeu vetem nga pikepamja e tij si personazh historik, nje princ i vertete shqiptar i shekullit te 15 origjina e te cilit mund te gjurmohet permes dokumentave historike dhe provave materiale qe dalin dhe analizohen brenda kufijve akademike. Sigurisht, keto studime nuk jane pa vlere. Fatkeqsisht, shumica e studiuesve i konsiderojne elemente te vlefshme dhe aspekte te panjohura me pare si dytesore. Studiuesit

akademike kufizohen tek materialja, tek empirikja. Gjithe elementet legjendare te lidhur me Skenderbeun mezi studiohen. Duke vleresuar kerkimin shkencor dhe akademik, studiuesit kane tendencen te neglizhojne perrallat dhe legjendat si produkte te imagjinates dhe asgje me shume. Ato vleresohen vetem ne relate me te vertetat historike.

Se dyti, akademia ka vene nje vize te pakalueshme mes fizikes dhe metafizikes. Kjo nuk eshte cudi, duke pare tendencat moderniste, por ka patur efektin qe e ka vene inferioren siper superiores. Pra, cdo karakter historik te cilit i eshte dhene nje status mbinatyror analizohet vetem permes aspekteve me materialiste. Studiuesit moderne tregojne te njejten mendesi si diletantet e antikitetit qe kujtonin se zotat e asaj periudhe ishin vetem njerez. Per shkak te ketyre paragjykimeve, Skenderbeut i eshte rrjepur nje pjese esenciale e vetes.

Per sa i perket metodes Tradicionaliste, ajo nuk i shikon mitet, legjendat apo perrallat si te rreme apo si produkte te imagjinates; por i vlereson duke thene qe permbajne me shume te verteta se cdo kerkim modern i historise qe sheh vetem planin material. Ashtu sic ka shpjeguar Julius Evola: "Elementi karakteristik i metodes qe une e quaj 'tradicionale' (ne kundërshtim me profanen, empiriken dhe kritiko-intelektualen te studimeve moderne), konsiston ne theksimin e karakterit universal te nje simboli apo mesimi, dhe duke e lidhur ate me simbole te gjetura ne tradita te tjera, dhe vendos keshtu nje prezence te dickaje qe

eshte superiore dhe e parakohshme ndaj ketyre formulimeve, te cilat jane te ndryshme por ekuivalente me njera tjetren. Meqenese nje tradite mund t'i kete dhene nje kuptimi te rendomte nje shprehi me te plote, tipike dhe transparente se sa kane bere te tjerat, duke u perpjekur te vendose korresponcenca, eshte per pasoje nje nga rruget me te frytshme per te kuptuar dhe integruar ate cka ne raste te tjera gjendet ne forme me fragmentare."

Ai shton:"Referenca e re ndihmon ne qartesimin e nje tradite permes nje tjetre apo te kuptosh nje tradite permes elementit universal, metafizik dhe suprahistorik qe mund te jete me i dukshem ne nje simbol korrespondent i formuluar ne nje tradite tjetere. Me fjale te tjera, kjo shkakton ndryshimin ne kendveshtrim nga nje model me dy permasa ne nje model me 3 permasa, ku shtohet thellesia, e cila mund te veproje si nje qender renditese per te gjitha te dhenat e tjera."

Metoda Tradicionale heton kuptimin e legjendave dhe simboleve, e vetedijshme per rendesine e tyre, sidomos kur tregojne elemente te cuditshme, fantastike apo te pamundura. Keto elemente jane te pranishme ne legjenden e Skenderbeut, por pergjithesisht shihen si elemente ahistorike. Por nje sy i stervitur e sheh kuptimin me te thelle, qe eshte i padukshem per studiuesit profane. Sic shprehet perandori romak Juliani: "Kur mitet ose temat e shenjta nuk jane kongruente me mendimin, ashtu ato therrasin me ze te larte dhe na ftojne te mos i besojme fjale-per-fjale por te studiojme kuptimin e tyre te fshehur." Pra, vlera e folklorit nuk

mund dhe nuk duhet te neglizhohet pasi mbledh dicka qe shkon pertej planit historik.

Sa per vleren e folklorit, Rene Guenon ka shprehur kete mendim: "[Folklori] pothuajse ne cdo rast, permban elemente tradicionale ne kuptimin e plote te fjales, edhe pse shpesh jane te zbehur, te deformuar apo te copetuar. Keto elemente kane nje vlere simbolike te vertete dhe, jo vetem qe nuk burojne nga mendja e njeriut, por nuk kane as origjine njerezore; e vetmja gje popullore per to eshte qe kane "mbijetuar", duke pare se si keto elemente i perkasin formave tradicionale qe tani jane zhdukur. Keto forma te zhdukura tradicionale ndonjehere kane origjine aq te lashte sa do te ishte e pamundur ta zbuloje saktesisht, nje te shkuar qe eshte e kufizuar tek fusha misterioze e prehistorise. Ne kete drejtim, njerezit veprojne si nje memorje kolektive dhe e nenndergjegjshme, permbajtja e te ciles derivohet nga nje burim tjetër."

Disa do te kundërshtojne ketu duke thene se Skenderbeu, si karakter historik, nuk eshte i pershtatshem per metoden Tradicionale dhe citatet e mesiperme nuk mund te zbatohen tek ai; ato citate jane me te pershtatshme per nje personazh si mbreti Artur, i cili eshte disi historik, por gjendet kryesisht ne legjenda. Ashtu si akademiket e sotem, keta individe nuk kuptojne qe elemente transhendente mund te misherohen ne planin fizik dhe historik, qe personazhe historike mund te ngrejne veten ne nje status mbi-njerezor qe njihet nga tradita, dhe qe metahistoria

mund t'i lidhe me historine. Keto nderlidhje lene pas nje varietet te gjere simbolesh, mitesh dhe doktrinash. Ashtu si shpjegon Julius Evola: "Ka realitete te nje rendi superior dhe arketipik, te cilat perfaqsohen ne menyra te ndryshme nga simbole dhe mite. Mund te ndodhe qe gjate historise, struktura te caktuara dhe personalitete do i misherojne keto realitete. Kur ndodh kjo, historia dhe superhistoria nderlidhen dhe integrojne njera tjetren; fantazia njerezore mund te mitizojë karakteret dhe strukturat ne menyre instinktive sepse realiteti eshte bere simbol dhe simboli realitet."

Per te dhene nje shembull ne te cilin historia dhe miti nderlidhen me nje realitet transhendent, duhet te permendim historine e hershme te Romes. Autoret si Georges Dumézil ne librin e tij Feja arkaike romake kane treguar qe mitologjia e hershme romake ishte e barazuar me historine e tyre te hershme. Per me teper, autori shqiptar Arshi Pipa ka identifikuar kete trend edhe ne mitologjine shqiptare. Duke perdorur konceptin ciklik te historise nga Giambattista Vico, ku historia kalon nga nje faze teologjike ne nje faze historike dhe me pas ne nje faze humane, Pipa thote qe mitologjia shqiptare ka zene rrenje ne fazen e dyte. Kjo eshte tamam faza ku gjejme Skenderbeun. Legjenda e tij eshte plot tematika mitike, dhe atmosfera qe e rrethon ka te beje me shume me legjenda qe citohen si histori dhe histori qe kalon ne nivelin e mitologjise.

Nga cfare kemi thene, nuk ka dyshim qe mitologjite, legjendat dhe perrallat tregojne tematike dhe simbole me kuptime me te thella. Vetem Tradita mund te na jape nje celes per te deshifruar keto kuptime. Ata qe nuk jane ne dijeni te ketij celesi ndalojne tek aspektet ekzoterike te miteve, legjendave, dhe perrallave, kurse te tjeret zbulojne kuptimin ezoterik.

- Ezotericizmi i Skenderbeut

Nje verejtje nga Rene Guenon vlen per studimin tone: "Kur nje forme tradicionale eshte afer zhdukjes, perfaqesuesit e saj te fundit mund ta ruajne ate memorje kolektive qe ndryshe do kishte humbur. Kjo eshte menyra e vetme per te shpetuar cka mund te shpetohet. Ne te njejten kohe, mungesa e natyrshme e kuptimit nga masat eshte nje garanci e mjaftueshme qe ajo cka kishte nje karakter ezoterik mund te mos humbase, por mund te vazhdoje te ekzistojte si nje lloj deshmitari te te kaluares per ata ne nje epoke te mevonshme qe do te jene ne gjendje ta kuptojme."

Ky observim pershtetet me kontekstin ne te cilin lindi legjenda e Skenderbeut. Pushtimi i Shqiperise nga forcat turke ishte nje kercenim aq ekzistencial, ne cdo nivel, saqe cka mbijetoi ne legjenda per Skenderbeun mund te ruaje, ne nje menyre pothuaj te pandryshuar por nen maskim, berthamen e doktrinave tradicionale te kesaj epoke, ato vete vijne nga epoka me te hershme. Pra, mund te flasim per nje karakter ezoterik te

legjendes se Skenderbeut qe nuk eshte vene re deri me tani. Dhe kjo prezence, ky realitet absolut i motiveve ezoterike te Skenderbeut ashtu si dhe simbolet te lidhura me te, do t'i psembledhim nen emrin ezotericizmi i Skenderbeut.

Ezotericizmi eshte dije tradicionale, e kaluar nga nje numer i vogel njerezish permes gojedhenes, duke i lejuar te kapin kuptimin e fshehur metafizik te miteve, legjendave, dhe perrallave pavaresisht maskimeve te tyre te shumta. Etimologjikisht do te thote ajo cka eshte fshehur brenda, dhe si e tille eshte ne kundërshtim me ekzotericizmin (qe do te thote ajo cka eshte jashte) dhe vetem gervisht siperfaqen pa arritur te kape kuptimet me te thella. Pra, legjenda e Skenderbeut mund te interpretohet ne menyre ekzoterike dhe ezoterike, edhe pse doktrinat ekzoterike nuk mund t'i kapin kuptimet me te thella, shpirtërore ashtu si interpretimi ezoterik, dhe ky i fundit ne fakt dominon. Por Skenderbeu nuk limitohet me nje legjende, ai eshte i lidhur me shume simbole te tjera. Simbolet vete kane kuptime ezoterike, pra simbolet qe perdor Skenderbeu nuk duhet injoruar se jane po aq te rendesishem sa legjenda.

Legjenda dhe trashëgimia e Skenderbeut jane plot me simbole, qe nga shqiponja me dy krena e deri tek helmeta, dhe perfshijme ketu edhe vulen e tij sekrete ashtu si armet e tij. Interpretimi tradicional i simboleve, i quajtur simbolizem, i shikon si imazhe nga plani fizik qe reflektojne realitete me te larta (si mikrokozmosi reflekton makrokozmosin). Ata ofrojne nje ure drejt kuptimit te



principeve metafizike. Si te tille, mund edhe te kene nje kutpim 'zyrtar' ekzoterik, por prapeseprape tejcojne mesazhe ezoterike. Simbolet e lidhura me Skenderbeun jane nje shembull i mire per kete: jane te mirenjohura dhe lehtesisht te dallueshme nga kushdo, por shume pak e kapin kuptimin e tyre te thelle dhe shpjegimet zyrtare shpesh nuk mjaftojne pasi jane bosh. Pra, per sa i perket pasurise se simboleve te Skenderbeut, mund te flasim per ekzistencen e nje simbolizmi qe mban, bashke me legjenden e tij, nje karakter specifik ezoterik. Deri me tani i injoruar, ezotericizmi i pasur i Skenderbeut eshte nje trashegimi e gjalle e nje tradite metafizike.

Pra, duke perdorur metodiken Tradicionale ne rastin e Skenderbeut do ne nxjerrim ne pah elemente nga tradita te tjera qe perputhen me simbolet e lidhura me heroin tone dhe tematikat e gjendura ne legjende. Duke krahasuar keto elemente, do te theksojme esencen dhe vleren metafizike te ezotericizmit te Skenderbeut. Per te shmangur konfuzionin, ky studim do te ndahet nje dy pjese: nje qe rrotullohet rreth simboleve te heroit dhe kuptimit te tyre, duke filluar qe nga ikonografia me e vjeter e deri tek studimet mbi helmeten dhe flamurin; pjesa tjeter do te fokusohet tek legjenda dhe tematikat e gjendura ne to ne shpirtin e metodes tradicionale qe kemi permendur me lart.

# Pjesa e I: Simbolet

# Ikonografia me e vjeter e armeve te Skenderbeut

**S**kenderbeu nuk la pas vetes as varr e as trup. Te vetmet artifakte materiale te lena pas nga ai jane shpata dhe helmeta. Studimet e ketyre dy shekujve te fundit kane gjetur vula dhe elemente te tjera te lidhura me Skenderbeun por me te rendesishmet mbeten shpata dhe helmeta. Keto dy objekte jane relika te Skenderbeut, gjithashtu dhe shenjat e tij mbreterore.

Rasti i shpates eshte me kompleks, sepse Skenderbeu eshte lidhur vetem me nje shpate edhe pse ne fakt ka patur dy shpata. Sidoqofte, fakti qe nje shpate e vetme u gjet ne fillim ka rendesi me te madhe ketu. Hera e pare qe shenjat mbreterore jane paraqitur eshte tek "Armamentarium Heroicum", katalogu i koleksionit te armeve te mbajtura nga Arkiduka Ferdinandi II ne keshtjellen Ambras. Gravura e Skenderbeut nga Dominicus Custos, sipas modelit te Giovani Battista Fontana, e paraqet duke mbajtur shpaten ne nje dore, dhe ne te njejten kohe duke e treguar kete shpate me gishtin tregues te dores tjeter; helmeta e tij eshte ne toke. Ketu ka disa elemente kurioze nese perqendrohemi tek keto dy objekte, sidomos tek metalet te perdorura tek to.

Metalet e shpates dhe helmetes ngjasojne me metalet e perdorura nga Hesiodi per te pershkruar kendveshtrimin tradicionalist ciklik te historise. Kendveshtrimi ciklik i historise, gjithashtu i gjendur tek fete Romake dhe Vedike, prezanton ne de-evolucion ciklik nga nje Epoke e Arte ne nje te Argjendte qe ndiqet nga nje Epoke Heroike/Epoke Bronzi dhe perfundom me Epoken e Hekurit. Helmeta dhe shpata permbajne metalet e Kater Epokave te Hesiodit dhe mund te kuptohen si nje kujtim i kesaj. Shpata eshte e dekoruar me ar, dhe legjenda i jep fuqi magjike, por per pjesen me te madhe eshte prej celiku. Karakteristika luftetare e shpates eshte e vetekuptueshme, por duke lidhur metalet e saj me Epokat e Hesiodit, mund te marrim mesazhin: vetem nese e zoteron kete shpate mund te kthesh Epoken e Hekurit ne nje Epoke Ari, gati si nje proces alkimik. Dhe fakti qe vetem luftetari mund te pretendoje te kete nje shpate eshte nje e dhene drejt karakteristikave shpirterore te nevojitura per kete detyre.

Helmeta prezanton te njejtin cikel de-evolucionit. Kemi koken e dhise prej ari, pjesen e brendshme te bazes prej nje metali te bardhe qe duket si argjend dhe nje shirit te jashtem bakri me nje monogram qe vjen rreth helmetes. Bakri ketu eshte ekuivalenti i bronzit, dhe bronz gjejme edhe ne nje pjese te vogel te helmetes direkt poshte pjeses se arit. Kjo lidh bashke Epoken e Arte me Epoken Heroike. Epoka heroike eshte pjese e fundit e Epokes se Bronzit, dhe i vetmi perjashtim i de-evolucionit, pasi ketu kemi nje permiresim afatshkurter. Per me teper, fakti qe koka e dhise

eshte e lare ne ar tregon lidhjen mes ketij simboli dhe Epokes se Arte sic do tregojme me vone.

Per tani, do te perpiqemi te shpjegojme kuptimet ezoterike te helmetes ne lidhje me shpaten. Ne shiritin prej bakri, kemi 6 trendafila dhe mes tyre, germat "Inperatore bt". Trendafili eshte lulja me e shenjte e perendimit. Ekuivalenti lindor eshte lulja e lotusit, e cila ne traditat lindore si tantrizmi, perdoret per te simbolizuar shtate cakrat, shtate qendrat shpirterore sekrete te pranishme ne trup. Ne menyre analoge, kemi gjashte trendafila ne helmete qe korrespondonje me 6 cakra.

Per me teper, kemi permendur qe shpata eshte ngritur kurse helmeta eshte ne toke. Duke marre parasysh qe shpata eshte e vetmja mbetje materiale e Skenderbeut qe u gjet e para duhet te kuptojme cfare do te thote ky simbol.

Nje te dhene e gjejme ne Orient: sipas doktrineve Taoiste, ne varret e te mencurve dhe shenjtove nuk ka kufome, por vetem nje shpate. Shpata eshte simboli i anes okulte te shtylles kurrizore, perfaqeson Sushumnan ne mesimet tantrike. Tek baza e saj qendron cakra e pare. Kjo pasqyron menyren se si Skenderbeu po tregon shpaten (i vetmi send ne varrin e Skenderbeut) dhe helmeta eshte ne toke, pra tek baza, dhe lidhjen e helmetes me cakrat e permendem me lart.

# Kreshta ne formen e dhise

**D**ikush mund te jape kunderargumentin qe ka vetem 6 trendafila ne helmeten e Skenderbeut, po shtate cakra. Eshte nje verejtje e mire. Ama, cakra e shtate gjendet ne maje te kokes, dhe kjo pasqyrohet tek pozicioni i kokes se dhise ne helmete. Tek tradita lindore Hindu, cakra e fundit eshte vendi ku zoti Shiva bashkohet me gruan e tij, perendeshen Shakti. Nje jehone e kesaj hierogamie (martese te shenjte) ekziston tek turnete mesjetare, ku kaloresit dyluftonin per favorin e Dames. Kaloresit shpesh mbanin nje helmete te formuar sipas formes se nje kafshe, nje kafshe e cila gjendej shpesh, edhe pse jo gjithmone, edhe ne stemen e tyre. Kjo pjese e helmetes, e quajtur kreshte, perdorej per te identifikuar kaloresin dhe mes te tjerave, eshte edhe e lidhur me koken, me cakren e shtate. Kete gje e shikojme dhe tek helmeta e Skenderbeut.

Kreshta jep pershtypjen e elementit qe del nga kraniumi i kaloresit. Kur nje luftetar arrin dicka qe ka domethenie shpirterore, ai shpesh krahasohet me shpirtin e nje kafshe. Lidhja e berserkerave nordike me arinjte eshte nje shembull i mirenjohur i ketj fenomeni. Shpirti i kafshes ka te beje gjithashtu me ate cka greket e lashte e quanin daemon, romaket genius dhe nordiket fylgja; shpirti kolektiv i nje race, fisi apo familjeje qe ndjek cdo

individ dhe influencon jeten e tij. Kendveshtrimi modern i njeriut si nje qenie individualiste dhe egocentrike ka harruar qe ka pjese te vetes te cilat shkojne pertej planit individual. Duke pare se si ky shpirt eshte i lidhur si me individin, ashtu dhe me racen, edhe kombe te tera mund te kene daemonin e tyre. Eshte nje rast tjetër ku makrokozmosi reflektohet tek mikrokozmosi, sic ka shpjeguar Hermes Trismegistus dhe tradita te tjera.

Pika e fundit ka qene nje lloj konsensusi mes te iniciuarve te botes tradicionale. Sipas Ptolemeut, Thrakia, Maqedonia dhe Iliria udhehiqeshin nga shenja astrologjike e Bricjapit, nje krijese gjysem dhi dhe gjysem peshk. Ketu mund te shtohet dhe Epiri. Ngjashmeria ne karakter mes ketyre popujve njihej qe ne antikitet. Koka e dhise ka qene e pershtatur me se miri ndaj Skenderbeut, i cili njihej si zoti i Emathias (rajon i lidhur si me Maqedonine ashtu edhe me lumin Mat), zot i Epiroteve dhe zot i Shqipareve (Ilireve), dicka qe na ben te mendojme qe ka patur nje vazhdueshmeri ezoterike mes daemontit te paraardhesve te tij dhe daemontit vetjak.

Nje aspekt interesant i Bricjapit eshte lidhja e tij me Diellin. Gjate muajit te Bricjapit kemi Solsticin e Dimrit, naten me te erret, por qe nga ai moment ditet behen gjithnje e me te gjata. Solstici i dimrit ishte nje festivitete me rendesi ne shume tradita Arjane. Ne Rome, ai lidhej me kultin e Diellit te Pamposhtur, Sol Invictus, "dii solis natali". Aureliani, nje perandor romak me origjine ilire, ishte shume i lidhur me kete kult. Bricjapi mban ne vete idene e

pamposhtmerise se diellit. Per me teper, koha e Bricjapit perfaqeson kohen e vitit me te favorshme per zbulime shpirterore. Kendveshtrimi tradicional i kohes njej kohet e mira dhe kohet e keqija per te ndermarre vepra te ndryshme, qe nga lufterat tek te korrurat e tek ushtrimet shpirterore. Pra, shenja e Bricjapit shenjon nje arritje shpirterore.

Ndonjehere, ndodh nje ngaterrese mes Bricjapit dhe dhise se Zeusit Amalthea, edhe pse ne fakt mund te mos duken shume te lidhura. Por kjo ngaterrese ndoshta eshte shtyse per te investiguar ne lidhjet e mundshme te Amaltheas me kete teme. Amalthea ka disa lidhje me konceptin e pamposhtmerise qe gjendet tek Aegisi misterioz.

Amalthea ishte dhia qe ushqeu Zeusin foshnje ne Krete. Me vone, Zeusi e perdori lekuren e saj per te bere Aegisin, mburoje e vecante qe u perdor nga shume perendi dhe njerez. Pergjithesisht nje simbol i suveranitetit hyjnor, atij qe e kishte, i jepej pathyeshmeri nga zotat. Kjo eshte shpjegim per shprehjen "te jesh nen aegis". Identifikimi i dhise ne helmete me Amalthean nuk eshte pa kuptim, pasi dhia e Zeusit qe perfaqeson Aegisin behet rekordi i pamposhtmerise se Skenderbeut. Ne mite te tjera, Aegisi kuptohet si mburoja qe Zeusi i jep Perendeshes Athina. Ky koncept shpjegon perse Skenderbeu luftonte me krahun e djathte te zhveshur, gati sikur po mbante Aegisin me vete.



Rryma e nendheshme mes Skenderbeut dhe zotave te Antikitetit shkon me thelle. Agni, zoti Vedik Arjan i Zjarrit paraqitet duke kaleruar nje cjar. Agni eshte i lidhur etimologjikisht me zotin prekristian shqiptar Enji, nga i cili kemi emrin e dites se enjte. Ne traditat e tjera evropiane, e enjtja lidhet me zotat e bubullimes dhe vetetimes si Jupiteri dhe Thori. Sidoqofte, vetetimat pershkruheshin si zjarr ne qiell, pra tematika e pergjithshme vazhdon.

Per me teper, dhia thuhet te kete qene kafsha e shenjte e ekuivalentes shqiptare te perendeshes greke Artemis, qe mbijeton ne folklorin shqiptar si Zana e malit. Etimologjia e Zanes e lidh me Dianen, ekuivalenten romake te Artemises. Perrallat shqiptare e paraqesin ate si nje shpirt te mire, qe nga qumeshti i gjirit te saj, i jep luftetarit force te papare. Tradita nordike duhet permendur ketu gjithashtu, sepse luftetaret e vrare shkojne ne Valhalla, ne hollin e heronjve, duke kaleruar nje dhie ne pemen Yggdrasil. Dhia hyjnore me emrin Heidrun thuhet qe kafshon pemen e shenjte kozmike te kozmologjise nordike. Heidrun pastaj prodhon birren e shenjte qe konsumohet si nga zotat ashtu dhe nga luftetaret e Odinit.

Keto tematika pasqyrojne marrjen e qumeshtit te Amaltheas nga Zeusi dhe marrin nje dimension te ri nese e lidhim me cornucopian e famshme, me bririn e bollekut, simbol i bollekut dhe ushqimit, me nje nga briret e Amaltheas.

# Briret dhe natyra e tyre

**B**ririt e helmetes se Skenderbeut jane pa dyshim nje nga elementet me te komentuar. Shkollaret moderne i lidhin vetem me Pirron dhe Aleksandrin, interpretim ky qe edhe pse i sakte, eshte vetem siperfaqesor. Ne ndryshim nga liderat historike qe sapo permendem, hyjnia dorike Apollo Karneios, Apolloni me Brire, nuk eshte lidhur kurre me Skenderbeun pavaresisht ketij elementi te perbashket. Artikulli i Rene Guenon "Simbolizmi i brireve" na jep informacione interesante. Ai shpjegon qe "Pushteti dhe ngritja mund te lidhen simbolikisht me malet, por edhe me shume me briret." dhe shton qe epiteti i Apollo karneios, pra Karneios, pervec perkthimit "me brire" mund te perkthehet edhe si "i fuqishem" ose "i pushtetshem". Ne rastin e Skenderbeut, pozicionimi i brireve ne maje te helmetes jep idene e ngritjes dhe ka nje aspekt superior dhe diellor, ndoshta edhe me shume se helmetat vikinge me brire.

Tradicionalisht, briret ndahen ne dy kategori: diellore dhe henore. Kjo ndarje ka te beje me format qe marrin briret, dhe reflektojne nje lloj spiritualiteti te perfaqesuar nga ata qe veshin briret diellore dhe henore. Briret e dashit imitojne diellin, kurse ato te demit

imitojne henen ne forme draperi. Spiritualiteti mashkullor, aktiv, heroik perfaqesohet nga briret e dashit, te gjendura te perendia egjiptiane Amon, i identifikuar me Zeusin grek. Keto lloj briresh mbante dhe Aleksandri i Madh. Nga ana tjeter kemi spiritualitetet me orientim femeror, qe kane aspekte ktonike, kontemplative dhe pasive; keto tregojne brire demi (mbaheshin nga prifterinjte te kultit te Dionisit, apo ne statujat e perendive te lindjes se mesme). Me pak informacion ka per briret e dhise, por lidhja e tyre me Panin dhe Faustusin tregojne konceptin tejet indo-evropian te perendise me brire.

Perendia Dorike Apollo Karneios eshte nje shembull i nje perendie te tille i perfaqesuar nga briret e tij, ne traditen kelte kemi Kernunnosin, dhe ne traditen Hindu kemi Pusanin (etimologjikisht i lidhur me \*Pauson, qe mendohet te kete qene emri origjinal i kesaj perendie). Kjo perendi eshte i lidhur me dhente, i udheheq dhe i mbron nga kafshet e egra, pra eshte shume popullor me barninjte edhe pse ky rol perfshinte dhe udheheqjen dhe mbrojtjen shpirterore. Sidoqofte, kjo perendi duket te jete zhdukur ne Evrope. Ne fakt, mbijetoi vetem ne ato cka ne quajme traditat paleo ballkanike, te perfaqesuara nga Iliria, Maqedonia dhe Epiri. Lideret e ketyre kombeve ishin trupezimi fizik i kesaj perendie, dhe i jepeshin fuqi qe kishin te benin me mbrojtjen e tufes se dhenve nga armiqte. Influenca metafizike e lartpermendur gjeti favor mes kombeve te barinjve, kjo hyjni u trupezua plotesisht nga Pirro i Epirit, Filipi V i Maqedonise dhe me vone

Skenderbeu. Kjo eshte prove e nje konceptimi te larte te nje dinjiteti tradicional te shenjte mbreteror. Paraqitja e brireve te dhise ne helmetat e ketyre mbreterve ishte nje pjese e rendesishme e simboleve mbreterore. Helmeta e Skenderbeut mund te konsiderohet pra si kurora e Shqiperise.

Citojme perseri artikullin e lartpermendur, kurora dhe briret jane te lidhura etimologjikisht dhe simbolikisht, te dyja jane manifestime hyjnore te rrezeve te drites. Sipas Guenonit, fjala greke e lashte per rrufene (keraunos) eshte gjithashtu e lidhur me kete etimologji. Rrufeja godet shpesh majat e maleve. Legjenda e Skenderbeut ku pishtare lidhen tek briret e dhenve per te mashtruar ushtrene osmane eshte nje jehone e brireve si arme simbolike, e ngjashme me rrufene e Zeusit.

Si simbol dual, briret kane te bejne me zoterimin e pushtetit shpirteror dhe temporal. Rrezet e drites jane nje simbol i pershtatshem per pushtetin, fillimisht ate prifteror dhe mbreteror e pastaj per ate shpirteror dhe temporal. Mbajtesi legjitimizohet nga vete burimi i drites.

Kjo korrespondon me ate cka permendem me larte mbi mbreterit e shenjte te tradites paleo ballkanike. Pra, helmeta me brire e Skenderbeut eshte nje simbol i cilesive te tij te udheheqjes ne planin fizik dhe metafizik, dhe i fuqise mistike nen zoterimin e tij: auctoritas-i i tij dhe imperium-i i tij, ne terma romake.

Nje dualitet tjetër që ia vlen të përmendet dhe që ndan të njëjtin kuptim ezoterik, ka të bëjë me dy shpatat e Skenderbeut. Kjo është një temë që gjendet në literaturën Ghibeline si një metaforë për Perandorin e shenjtë që ribashkon fuqitë shpirtërore dhe temporale dhe që sundon mbi një perandori.

Sic thame, një interpretim i përhapur i helmetes së Skenderbeut ka të bëjë me brirët e Aleksandrit: si bir i Zeus-Amonit, Aleksandri paraqitet me brirë në monedha dhe iu vu nofka "ai me dy brirë". Këtu, brirët janë simbol i pushtetit mbi Orient dhe Oksident. Guenon flet për ngjashmerinë e kësaj domethënieje me atë të shqiponjes me dy këna.

# Shqiponja dykrenare dhe miti i dy zogjve

**S**hqiponja e zeze me dy krena ne nje fushe te kuqe ishte stema e familjes Kastrioti dhe tani eshte flamuri i Shqiperise. Skenderbeu e perdori kudo: ne flamur, ne steme dhe ne vule. Sipas Guenonit, ky simbol do te thote pasjen e pushtetit mbi Orientin dhe Oksidentin dhe lidhet dhe me simbole te tjera indo-evropiane te burrerise olimpike qe kane karakter dual, si Dioskuret dhe boshti i dyfishte. Mes tyre, shqiponja ruan nje vend te vecante.

Ne pergjithesi, shqiponja ka rendesi te madhe ne traditen indo-evropiane, dhe ne varesi te kultures, ose lidhet me Zotin e Qiellit, liderin e panteonit ose me Bubullimesin - ne disa raste keto dy perendi jane e njejta. Nje nga shembujt me te mirenjohur eshte Zeusi. Perendia vedike arjane Vishnu ka shqiponjen Garuda, kurse Odini ka dy korba te zinj. Shqiponja e zeze dykrenare e Perandorise se Shenjte Romake evokon zogjte e Odinit, simbol dhe arketip i paharruar, edhe pas shume shekujsh konvertimi. Pra, flamuri i Skenderbeut kerkon vemendjen tone te plote pasi mund te jete manifestimi i elementeve simbolike te nje supra memorijeje arketipike.

Pervec vete zogut si simbol i perendise, ka edhe nje mit mbi Orakullin e Delfit qe thote se si Zeusi dergoi dy zogj per te gjetur qendren e Tokes, jehone e dy kokave te flamurit te Skenderbeut. Por nje mit tjetër është me i kenaqshëm pasi tregon me sakte lidhjen mes Zeusit dhe dy zogjve. Flet për krijimin e qendrave orakullare të Dodones dhe Siwas. Thuhet që dy zogj fluturuan nga Egjipti në Siwa dhe në Dodona për të thënë njëzëre aty vendet me të pershtatshme për të organizuar një orakull të shenjtë dedikuar ndaj Zeusit. Siwa ishte vendi ku Aleksandri i Madh u njoh si biri i Amon-Zeusit (dhe ku portretizimet e tij me brirë filluan). Sa për Dodonën, kulti orakullar rrotullohej rreth një peme të shenjtë lisi.

Ngjyra e zeze e zogjve na kujton flamurin shqiptar, edhe me shumë kur nuk kemi një shpjegim me të mirë për ngjyrën e shqiptonjes. Heraldika ndalon venien e ngjyrave normale mbi ngjyra normale; mund të vesh vetëm ngjyra metalike (argjend, ar etj) sipër ngjyrave normale (e kuqe, blu etj) ose e anasjellta. Të vesh të kuqe mbi të zeze do të ishte konsideruar një gjest injorant nga familjet feudale të tjera, nëse nuk do të kishte një kuptim me të thellë. Fakti që zogjtë kerkuan krijimin e një vendi orakullar në nder të Zeusit specifikisht na bën të mendojmë që ata zogj ishin simbol i këtij zoti, ashtu siç janë shqiptonjat. Pra, identifikimi i këtyre dy zogjve të zinj me shqiptonjen dykrenare të flamurit shqiptar nuk është i palogjikshëm.

Vendi orakullar ne Dodone gjendej ne Epir, pra jo larg Shqiperise moderne. Kulti vervitej rreth nje peme te shenje lisi qe rrenjet i kishte brenda nje shkembi, dhe aty prane gjendej nje burim uji, peizazhi ishte i dominuar nga mali Tomaros. Pavaresisht se sot e kesaj dite gjendet ne Greqi dhe se permendet ne antikitet vetem nga burimet greke , duhet te theksojme qe Dodona ishte nje institut ilir, dhe jo grek. Nje rastesi kurioze duhet permendur ketu: mali Tomaros eshte i lidhur etimologjikisht me malin shqiptar Tomorr. Kjo tregon per nje relate qe nuk kapet lehte nga nje mendje profane, por drita e Tradites na ndihmon ketu.

Tomaros dhe Tomorr jane te lidhura me fjalen proto indo evropiane \*temes, ne latinisht tenebrae, ne irlandishten e vjeter teme, ne gjermanishten e larte te vjeter \*demar, dhe te gjitha keto duan te thone erresire. Rene Guenon shton se qendrat tradicionale jane te rrethuara nga dy nocione: nje te brendshem, ezoterik dhe nje te jashtem, ekzoterik. I pari e perdor te zezen per te perfaqesuar nje qender te pamanifestuar (por qe ekziston si potencial), kurse tjetri perdor ngjyren e bardhe per te treguar qendren e manifestuar dhe te dukshme. Pra, nese mali Tomaros ka te beje me erresiren dhe te pamanifestuaren, Dodones i perket e manifestuara. Sipas Guenon, qendrat tradicionale te manifestuara thirren Albania (albus=e bardhe ne latinisht) per te shprehur idene e bardhesise. Nje rryme e panjohur por e pasur lidh Dodonen me Shqiperine, duke i dhene me shume peshe paralelit mes mitit te Dodones dhe flamurit te Skenderbeut.



Perdorimi i ketij flamuri duhet te shihet si nje rikthim i ketyre elementeve nga supra memorja e shqiptareve ne epoken e Skenderbeut.

Sa i perket shqiponjes dykrenare, Rene Guenon thote se si shqiponja dykrenare lind nga kombinimi i nje shqiponje normale me nje mjelme. Vishnu dhe Brahma jane dy nga tre zotat e trinitetit kryesor te fese vedike-arjane. Brahma kaleron mbi nje mjelme kurse Vishnu, sic kemi thene ne te kaluaren, kaleron nje shqiponje. Kjo eshte edhe e lidhur me mitin e Zeusit dhe Ledas, ku Zeusi, shqiponja, transformohet ne nje mjelme per te joshur Leden dhe nga unioni i tyre lindin binjaket Dioskuri. Vulat e Skenderbeut tregojne dicka me te vertete interesante. Vula e tij zyrtare ishte shqiponja dykrenare, por vula e tij sekrete tregon Leden me Zeusin te maskuar si mjelme. Ia vlen te permendet qe mjelma eshte edhe shpendi i Apollonit Hyperborean.

Ne lidhje me permendjen tone te pemes se shenjte te lisit ne Dodona, duhet te theksojme faktin qe lisi eshte nje simbol i boshtit te botes. Pema si bosht eshte nje imazh i zakonshem, por me pak te njohur jane zogjte qe jetojne ne kte peme. Kjo shprehet me se miri ne pemen Yggdrasil te tradites gjermanike. Ne maje te saj ka dy zogj, te pandashem, pasi ata jane nje zog i vetem. Tek Upanishadat arjane, keta dy zogj identifikohen si Jîvâtma dhe Paramâtma. Analog me kete jane Arjuna dhe Krishna qe qendrojne ne te njejten karroce: nje ka nje emer etimologjikisht te lidhur me fjalen "i bardhe" dhe tjetri ka nje emer etimologjikisht

te lidhur me fjalen "i zi", njeri eshte i vdekshem dhe tjetri i pavdekshem, njeri eshte i manifestuar dhe tjetri i pamanifestuar. Kjo ide lidhet me idene e mjeshterise qe ka te beje me shqiponjen dykrenare: mbi Orient dhe Oksident, mbi Jeten dhe Vdekjen, mbi Shpirteroren dhe Temporalen.

# Ngjyrat e shenjta te indo- evropianeve

**E** kuqja, e zeza, dhe e bardha, pervecse jane ngjyrat e flamurit te Skenderbeut, jane gjithashtu ngjyrat e Tradites Proto-Indo-Evropiane. Feja e tyre fokusohej goxha tek dita, \*dyew-, sic eshte rikonstruktuar nga gjuha e tyre, fenomen i lidhur me Diusin/Zeusin/Jupiterin. Ngjyrat perfaqsojne tre gjendjet e qiellit: i bardhe gjate dites, i zi gjate nates, dhe i kuq gjate agimit dhe muzgut. Nje mit i rendesishem i fese Proto-Indo-Evropiane eshte shpetimi i Hyjneshes se Agimit nga Binjaket Mitike (Dioskuret), bij te Hyjit te Dites (Jupiterit). Ngjyrat e flamurit nuk jane te rastesishme.

Ne alkimi, quajtur gjithashtu 'arti mbreteror', keto ngjyra jane te lidhura me udhen shpirterore heroike dhe mashkullore, dhe e percaktojne kete si udhen me te paster drejt Tradites Primordiale. Ato e tregojne Skenderbeun si ndjekes te nje spritualiteti Luftetar dhe Indo-Evropian.

Ne pjesen e kaluar permendem se si rrenja e fjales Krishna mund te perkthehet edhe si 'e zeze', ngjyre qe simbolizon te

pamanifestuaren; Hyji Suprem Krishna eshte personifikimi i te pamanifestuares. E zeza eshte gjithashtu e lidhur me qendra te shenjta, dhe ne rastin tone duhet te rikujtojme mitin qe permendem heren e kaluar, me dy zogjte e zinj dhe Orakullin Qendror te Dodones.

Ngjyra e kuqe eshte e lidhur me dinjitetin e shenje mbreteror dhe perandorak. Perandori Romak lyhej dhe vishej me te kuqe gjate nje triumfi, dhe behej simbol i vete Jupiterit, i cili sjell fitore duke perdorur avatarin e tij, Perandorin, si vegel. Nje jehone e kesaj gjendet tek titulli i Skenderbeut “Athleta Christi”, edhe pse ne forme te reduktuar.

Ylli i bardhe i emblemes se Skenderbeut mund te jete Ylli i Maqedonise, sic ka thene Barleti, por mund te jete dhe simbol i Ilirise. Yjete e bardha jane te lidhura me Polin e Veriut – origjina e Hiperboreaneve – apo nje qender me rendesi te ngjashme, si pershembull malet e Shenjta te Meruse, Olimpiti apo Tomorrit.

Simbolet Diellore dhe Polare jane ne marredhenie simbiotike me flamurin e Skenderbeut. Ato na kujtojne arketipin Indo-Evropian te Luftetarit dhe jane nje e dhene ndaj asaj cka paraardhesit tane konsideronin si udhen me te larte ezoterike.

# Pjesa e 2: Legjenda

# Skenderbeu dhe miti i birit te vejushes

**M**itet qe duken si evente historike nuk jane aspak te pazakonta dhe ne rastin e Shqiperise, tematika mitologjike pre-ekzistente jane perzier gjithmone me ate cka ne sot konsiderojme si histori. Ne legjenden e Skenderbeut, elementet mitike tregojne rrenje me te thella, te lidhura me Traditen Pereniale, edhe pse i jepet nje kontekst historik dhe nje karakter kombetar.

Nje element qe ka hutuar studiuesit profane eshte permendja e vdekjes se Sulltanit ne Shqiperi pasi ai deshtoi te merrte keshtjellen e Skenderbeut. Ky ndryshim i realitetit historik eshte pare thjesht se nje homazh ndaj heroit shqiptar, por eshte hedhur poshte si nje element jashtezakonisht ahistorik dhe prandaj mezi permendet. Ne vend qe te imitojme kete qendrim, ne duam te fokusohemi tek vdekja e Sulltanit. Ata qe e kane kujtuar kete vetem si homazh folklorik, kane deshtuar te kapin domethenien e vertete. Vdekja e Sulltanit eshte fitorja e Skenderbeut mbi te, dhe kjo fitore duket si permbushja e nje hakmarrjeje. Ky element i fundit nenvizon faktin qe jemi ne balle te nje versioni te vecante te nje miti antik arketipik.

Tema e hakmarrjes nuk eshte e rralle mes legjendave. Ky arketip mitologjik njihet si biri i vejushes, i identifikuar per here te pare nga studiuesi francez Jean-Claude Lozac'hmeur ne librin e tij *Fils de la veuve* (biri i vejushes). Nga ketu do marrim disa informacione, edhe pse nuk biem dakort me interpretimin e plote ne kete liber. Duke studiuar mitologjine e Graalit, ai ra ne perfundimin qe burimi nga vjen Graali eshte nje mit qe rrotullohet rreth nje heroi i cili merr hak per nje antar te familjes qe eshte vrare me pare. Struktura e pergjithshme e ketij miti eshte si vijon:

Nje mbret meson qe ai do te vrase nje nga trashegimtarete e tij. Duke qene se ka vetem nje vajze, mbreti e mbyll ate ne nje kulle te larte nga e cila ajo nuk mund te shpetoje. Nje hero apo perendi arrin te hyje ne kulle dhe te joshe princeshen. Nga ky bashkim lindin femije. Kur e merr vesh kete, mbreti ose e vret ose e plagos te dashurin e princeshes perpara se te heqe qafe nipat e tij. Bija, nje vejushe qe prej vdekjes se te dashurit, arrin te shpetoje nje nga bijte e tij dhe e fsheh ne pyll a ne shkretetire. Kur biri i vejushes behet burre, ajo i thote per origjinen e tij dhe i kerkon te marre hakun ndaj te atit dhe te vrase mbretin. I biri dylufton mbretin, i tejkalon te gjitha sfidat, shpeton nje princeshe dhe merr hakun per te atin.

Kjo kanavace mitike gjendet ne legjendat irlandeze, gjermanike, iraniane, franceze, latine dhe greke dhe ka si protagonist Lugun, Sigurdin, Kai Khurasaun, Yonekun, Romulin dhe Remusin, dhe

Perseun me Jasonin. Keto legjenda tregojne se si hero i ndihmohet nga elemente simbolike; ai merr dije sekrete duke i folur zogjve (ne legjendat irlandeze dhe gjermanike); ose nje hajmali e vecante i jep dije sekrete, forcen e luftetareve dhe bollekun e fermereve. Prezenca e tripartimit indo-evropian dhe theksi mbi dijen sekrete ne mit theksojne kerkimin ezoterik te dijes (gnosis) dhe inicimin mbreteror Indo-Evropian. Pra, miti duhet kuptuar ne kete menyre:

Nje zot i lig (mbreti) deshiron te mbaje dijen (princeshen) per vete. Nje zot i mire (babai) i sjell dijen njerezimit, duke krijuar ne menyre te tille nje rrace qeniesh superiore (bijte e princeshes) por ndeshkohet nga perendia e lige. Per me teper, perendia e lige perpiqet te shkaterroje njerezimin (bijte e princeshes) dhe dijen (vete princeshen, tashme nje vejushe) por deshton. Fale nje barke (jehone e kasketave te Remusit dhe Romulit, dhe Perseut) njerezimi mbijeton dhe e kalon historine ne brezat e ardhshem. Ata qe jane te iniciuar ne kete histori duhet te betohen te marrin hakun e babait, perendise te mire.

Ngjashmerite me mitin e Prometeut jane te pamohueshme, dhe duhet marre parasysh qe Eskili u akuzua per krimin e zbulimit te mistereve Elusiane ne dramat e tij (ndoshta tek Prometeu i lidhur), duke thelluar provat qe ky lloj miti ka nje dimension ezoterik. Disa versione te legjendes se Skenderbeut thone qe Gjoni u vra nga Sulltani. Poshte kemi ngjashmerite mes (I) mitit



Indo-Evropian, (2) Rrefenjes irlandese të Lugut, (3) Rrefenjes bretone të Yonekut, dhe (4) Legjendes e Skenderbeut :

(1) Tirani/Perendia e keqe ; (2) Balori, nje gjigant me nje sy magjik qe shkaterron ; (3) Zoti i Carwentit ; (4) Sulltani i Perandorise Osmane.

(1) Princesha/Dija ; (2) Ethne, bija e Balorit ; (3) Zonja e Carwentit ; (4) Shqiperia/keshtjella.

(1) Babai/Perendia e mire ; (2) Mac Kinealy, baba i Lugut ; (3) Nje hute qe transformohet ne nje kalores ; (4) Gjon Kastrioti, zot i Shqiperise qe lufton kunder Sulltanit.

(1) Ndeshkimi i babait ; (2) Balori i pret koken ; (3) Vritet nga zoti i Carwentit, shpata e tij i jepet zonjes se Carwentit ; (4) Sulltani pushton Shqiperine dhe më vone vret Gjonin.

(1) Ndeshkimi i vejushes (dijes) dhe i bijve (njerezimit) ; (2) Balor hedh tre nipat e tij ne lume, vetem Lugu mbijeton ; (3) nuk permendet ; (4) Bijte e Gjonit merren peng, vetem Gjergji mbijeton.

(1) Hakmarrja e te birit ; (2) Lugu vret Balorin ne beteje ; (3) Yoneku vret zotin e Carwentit me shpaten e te atit, qe ia ka dhene mamaja dhe behet zoti i ri i Carwentit ; (4) Skenderbeu merr keshtjellen e tij, mamaja i jep shpaten e babait, mposht Sulltanin, i cili gjen vdekjen ne Shqiperi.

Per me teper, Skenderbeu, pasi kthehet ne Shqiperi, takon mamane e tij (tashme vejushe) dhe ajo i jep shpaten e te atit. Ne disa legjenda, si legjenda franceze e Yonekut (nga Lais de Marie de France), mamaja e Yonekut, nje vejushe, i jep shpaten e te atit qe te marre hak. Disa variante te tjera (si legjenda e Batrazit, heroi osetian) thone qe vrasja e babait u be me vete shpaten e tij. Kulti misterioz i Mitras perfshin nje shpate te tille ne prezantimin e ikonografise se inicimit, duke perforcuar lidhjen mes mitit te birit te vejushes, legjendes se Skenderbeut dhe kultet tradicionale te inicimit.

Pra, nese identifikojme Sulltanin si perendine e lige, babai i Skenderbeut duhet te jete perendia i mire dhe Skenderbeu eshte heroi qe merr hakun e babait. Ky identifikim pershtatet me se miri me kontekstin e legjendes se Skenderbeut. Per sa i perket identifikimit me dijen (gnosis) ne shikojme keshtjellen e Skenderbeut si nje mundesi. Shume tradita e kane perdorur imazhin e keshtjelles per te pershkruar nje pjese te shenjte dhe te fshehur te shpirtit ku qendron dija (per shembull, fortesa e Graalit).

Ne traditat Indo-Evropiane, sovraniteti dhe dija jane e njejta gje dhe keshtu keshtjella e Skenderbeut perfaqeson sundimin e tij mbi Shqiperine, ashtu si dhe nje qender tradicionale. Si kemi thene me pare, ne gjeografine e shenjte, etimologjite qe permbajne emrin e ngjyres se bardhe indikojne qe aty gjendet nje qender

tradicionale. Kemi shpjeguar qe rrenja e fjales Albania do te thote e bardhe.

Nje element tjeter qe ia vlen te permendet eshte nje koleksion stemash feudale (Stemmatografia sive Armorum Illiricorum delineatio, descriptio et restitutio, 1701) qe e karakterizon Shqiperine me nje keshtjelle te bardhe dhe Dardanine me Epirin me fusha te bardha; teksti poshte stemes me keshtjellen e bardhe, e lidh ate haptas me Shqiperine, dhe Skenderbeu permendet gjithashtu. Aty shpjegohet qe "ngjyra e bardhe i reziston gjithë rreziqeve". Me keto elemente ne mendje, mund te dalim ne perfundimin qe keshtjella e Skenderbeut trupezon dy realitete simbolike: sundimin mbi Shqiperine dhe qendren e shenjte te dijes tradicionale.

Si permbledhje, elementet e legjendes se Skenderbeut perputhen me mitet e ndryshme te birit te vejushes: Lindja e Skenderbeut eshte e mbinatyrshe (enderra e mamase ka paralele me menyren se si linden heronjte); Shqiperia eshte nje qender tradicionale ne duart e Sulltanit (antagonisti i lig, ashtu si Balor gjiganti ne traditen irlandeze, si Amulius uzurpatori ne mitin e Remusit dhe Romulit, dhe si Kamsa, mbreti i lig ne traditen Hindu); Gjon Kastrioti revoltohet kunder Sulltanit por mposhtet (si Xaemycu, babai i Batrazit, i cili vritet); bijte e Gjonit merren peng dhe vetem Skenderbeu mbijeton (ashtu si Balori vret nipat e tij duke i hedhur ne lume, dhe Kamsai ekzekuton nipat e tij); Skenderbeu i sherben Sulltanit (ashtu si Lugu behet nxenes farketar per Balorin);

Skenderbeu revoltohet, merr prape keshtjellen e te atit dhe shpeton mamane - vejushe qe prej vdekjes se te atit - e cila i jep shpaten e babait (ashtu si Zonja e Carwentit ben me birin e saj); Skenderbeu merr hak per te atin duke mposhtur Sulltanin ne beteje dhe kjo ngjarje shkakton vdekjen e Sulltanit (ashtu si Krishna vret Kamsain dhe Lugu vret Balorin ne beteje).

# Gjuha e zogjve dhe bijte e shqiponjes

**S**ipas elementeve mitike qe kemi pare deri me tash, duket sikur shume prej tyre kane te bejne me inicimin e shenjte mbreteror indo evropian. Kerkimi per nje dije pothuaj te harruar (gnosis) qe duhet rikuperuar per te sjelle bollek ne vend ngjason me mitin e Graalit, i kerkuar nga Persivali, po ashtu biri i nje vejushe, dhe kjo shenjon mbijetesen e nje spiritualiteti diellor. Ky spiritualitet diellor mbreteror shprehet me se miri ne konceptin persian te lavdise, Xvarnah, qe permban elemente nga tri kasta indo evropiane ("drita e dijes, fuqia e luftetareve, bolleku i fermereve"). Nese kjo dije shpirterore humbet, vendi hyn ne nje epoke te erret.

Pra, dija (gnosis) dhe sovraniteti jane e njejta gje per indo evropianet dhe konceptet si Xvarnah e shprehin kete ide. Mbreterit e shenjte kane pushtet mbi prifterinjte, luftetaret dhe prodhuesit duke perfaqesuar tripartimin e kastave indo evropiane, dhe mund ta shikojme kete dhe tek shenjat mbreterore te Skenderbeut. Nje vend ku kjo tregohet eshte helmata, e cila perfshin te treja kastat: koka e dhise si simbol i kopese se dhenve

(simbol i barinjve si prodhues), Aegisi ose permendja e fjales "Imperator" ne shiritin prej bakri rreth helmetes si simbol i kastes luftetare, dhe briri i bollekut te Amaltheas i kutpuar si ushqim i pambaruar shpirteror. Por dicka tjeter na terheq vemendjen.

Shpata e Skenderbeut thuhet te kete gene aq e rende saqe askush pervec tij nuk mund ta ngrinte. Kjo ka ngjashmeri me Excaliburin e Mbretit Artur. Per me teper, eshte nje simbol i pershtatshem per kasten luftetare, kurse briri i bollekut te Amaltheas ne helmete perfaqeson bollekun qe vjen nga kasta e prodhuesve. Edhe pse dimensionin magjik i shpates mund ta lidhe ate me kasten prifterore, ne mendojme se shqiponja e zeze dykrenare pershtatet me shume per kete rol.

Mbreti i shenjte indo evropian iniciohet drejt dijes sekrete (gnosis) dhe kjo pasqyrohet ne mite. Nje shembull eshte kur Sigurdi i tradites gjermanike pi gjakun e Dragoit Fafnir dhe eshte ne gjendje te kuptoje zogjte qe e paralajmerojne nese ka rreziqe. Kjo aftesi i jepet Tiresiasit nga Perendesha greke e Dijes Athina, dhe me te vjen dhe aftesia per te bere profeci. Por shembulli me i dukshem eshte aftesia e Odinit per te folur me dy korbat e tij, dhe ashtu si Athinaja, ai eshte perendi i dijes. Aftesia per te folur dhe per te kuptuar gjuhen e zogjve eshte e barazvlefshme me inicimin drejt dijes sekrete hyjnore. Duket te kujtojme ketu mitin e dy zogjve te zinj te Dodones qe dine te flasin. Per me teper, figura ne pjesen e perparme te anijes se Jasonit mund te fliste me zogjte pasi ishte bere nga nje lis nga pylli i shenjte i Dodones.

Pra, Dodona eshte lidhja me gjuhen e zogjve dhe kuptimi yne i flamurit te Skenderbeut si nje paraqitje ezoterike e mitit te Dodones me dy zogjte e zinj merr nje tjeter dimension duke shpallur nje zoterim simbolik te gjuhes se zogjve. Kjo i jep Skenderbeut mencuri hyjnore, jo shume ndryshe nga mencuria qe kishte me te vertete. Edhe pse asnje mit nuk e pershkruan Skenderbeun duke folur me zogj, fakti qe gjuha shqipe ka kete emer dhe shqiptaret i vune vetes kete emer ca kohe pas luftes epike te Skenderbeut duhet te na terheqe vemendjen.

Etnonimi i shqiptareve dhe menyra si shohin gjuhen rrotullohen rreth nocionit te shqiponjes. Bijte e shqiponjes duhet te flasin gjuhen e ketij shpendi (shpendit te Zeusit), ndryshe nga te tjeret. Ketu kemi nje tematike qe duket shpesh ne doktrinat tradicionale dhe ne shoqerite indo evropiane: ndarja mes te iniciuarve dhe te tjereve. Ashtu se si epiteti Arya percakton nje popull dhe jo ata qe jane iniciuar tamam, te cilet njihen si dvija (qe do te thote i lindur dy here nepermjet inicimit), ne Shqiperi ndoshta vetem luftetaret e iniciuar te Skenderbeut (ose rrethi i tij i ngushte) mund t'i kene vene vetes epitetin Shqiptar, pra duke treguar aftesine e tyre per te kuptuar gjuhen e zogjve pas inicimit, perpara se te behej etnomini i popullit te rendomte pas katastrofes te pushtimit Osman.

Nje e dhene e nje inicimi te tille mund te gjendet ne doreshkrimin mesjetar te quajtur Bellifortis, nje veper per artin e luftes dhe keshtjelle-rrethimit. Nje tekst misterioz ne latinisht, qe nuk ka te

beje fare me pjesen tjeter te librit, eshte shtuar ne faqen e fundit, dhe pershkruan nje inicim, ose te pakten "liturgjine" e tij. Por disa rreshta mund te jene shkruar ne nje forme te hershme ose mesjetare te gjuhes shqipe. Ky liber thuhet t'i kete perkatur vete Skenderbeut. Nje studim me i sakte i tekstit duhet ndermarre qe te vijme me afer kesaj tradite antike incimi ne shqip. Sidoqofte, lidhjet me heroin tone, me ezotericizmin e tij dhe inicimin tradicional shqiptar jane te dukshme.

Identifikimi i kesaj tradite me ate te Dodones, ashtu si eshte sugjeruat nga cka kemi mbledhur ketu deri me tash, thellohet nga identiteti i shqiponjes si babai i shqiptareve. Shqiponja ishte ne antikitet nje epitet i Pirros se Epirit te cilit iu dha nga ushtaret e tij. Ashtu si Jean Gag  ka treguar ne veprat e tij, Pirro i Epirit ishte mbrojttes i tradites se Dodones, nje mbret i shenjte i iniciuar ne Dodone. Skenderbeu ne letrat e tij flet per Pirron dhe e konsideron paraardhes, nje paraardhes biologjik ne rradhe te pare, por ndoshta edhe nje shpirteror. Per shkak te perkatjes se tyre ne te njejten tradite, kjo e ben Skenderbeun gjithashtu nje bir te shqiponjes.

Perpara se te perfundojme, do te donim te permendim paralelin mes tradites antike Italike dhe piken e kthimit ne legjenden e Skenderbeut, dhe ndoshta e lidhur me shqiptaret si bij te



shqiponjes. Banda e Remusit dhe Romulit ndonjehere pershkruhej si bijte e ulkonjes. Ky nocion ka lidhje me praktiken ne Italine antike te ver sacrum: antaret me te rinj te shoqerise i dedikoheshin nje zoti qe me vone i udhehiqte drejt nje vendbanimi te ri. Ata te dedikuar ndaj zotit konsideroheshin si bijte e tij. Kjo eshte e pershtatshme ne rastin e Romulit dhe Remusit sepse ata jane bij te zotit Mars, simboli i te cilit ishte ujku. Shume tradita ilire kaluan dhe mbijetuan ne anen tjetere te Adriatikut dhe ver sacrum mund te jete nje prej tyre. Vendimi i Skenderbeut per te braktisur ushtrine osmane me 300 kalores shqiptare dhe per te ngritur flamurin e shqiponjes mund te jete nje deformim i ketij riti antik. Vetem se ne kete rast, zoti i larte nuk coi nje kafshe, por nje hero me nje shqiponje ne flamur.

# Qendra tradicionale e Dodones, Mbreti Artur dhe Skenderbeu

**D**uke pare episode specifike te legjendes se Skenderbeut, ne mund te dallojme shume ngjashmeri me mite te tjera antike. Ashtu sic kemi thene me pare, mitet nuk jane vetem perralla por tregojne nje trend metafizik dhe ezoterik kuptimi i te cilit ka humbur por mbijeton me shume si potencial per ata qe jane ne gjendje te kuptojne. Nje legjende e perhapur mesjetare per nje personazh te quajtur Guerrin Meschino dhe kerkimi i tij per origjinen e tij jehon me jeten e vete Skenderbeut dhe e ben ate pasqyrim te Guerrinit.

Guerrin Meschino ishte protagonisti i nje legjende ku kaloresi jetim Guerrin udheton boten ne kerkim te prinderve te tij, dhe zbulon ne fund qe eshte biri i mbretit te Shqiperise. Poshte ketij miti eshte kerkimi i evropianit dhe etja e tij per origjinen e tij, fizike dhe metafizike. Guerrini takon Priftin Gjon, Sibilen dhe karaktere te tjera pre-kristiane qe te mesoje me shume per origjinen e tij. Skenderbeu, nga ana tjetere, jo vetem qe kthehet ne

atdhe, por mbledh dhe paraqet simbole dhe koncepte Tradicionale ne shenjat e tij mbreterore, flamur, etj. si nje indikim te nje trendi ezoterik te pathyer i cili shkon pertej dy feve monoteiste te kohes. Mungesa e dogmatizmit fetar te Skenderbeut permendet shpesh ne rrefenjat popullore, duke e paraqitur ate as si totalisht musliman por as totalisht te krishtere, por sidoqofte, ai shihet si shenjtor i bekuar nga Zoti dhe nga Virgjerasha ne maje te malit.

Kjo eshte nje menyre per masat te kuptojne rrugen e te iniciuarit: ai nuk i perket asnje feje, por eshte prape se prape shenjtor. Ky paradoks eshte nje e dhene e lidhjes tradicionale te heroit tone. Sa i perket faktit qe u bekua nga nje virgjereshe, duhet permendur qe ne literaturen gnostike, mencuria simbolizohet shpesh nga nje grua e quajtur virgjerasha Sofia, ose thjesht Sofia. Kjo verejtje plotesohet nga fakti qe grate, si simbol, luajne nje rol te madh ne legjendat historike mesjetare. Dihet qe versioni Templar i adhurimit ekzoerik te Virgjereshes Maria ishte bekimi ezoterik i Sofise (gnosis, mencuri). Kaloresit Templare u akuzuan, para kohes se Skenderbeut, qe nuk ishin as te krishtere e as muslimane. Ne te kundert, ata zhvilluan ezoterizmin e tyre dhe nje gjurme e asaj gjendet tek legjenda e Graalit. Por kjo kerkon shume kohe per tu analizuar; rendesi ka qe te themi se Graali, duke simbolizuar Traditen qe duhet rekuperuar, sipas legjendes mbahej nga kalores pagane me shume se te Krishtere, dhe nuk mund te ngaterrohet fare me ekzotericizmin monoteist. Ashtu si Julius

Evola shpjegon tek Misteri i Graalit: "Per me teper, ekskluzivizmi dhe sektarianizmi jane karakteristika te ekzotericizmit, pra, te aspekteve profane dhe te jashtme te nje tradite, ketu gjejme perseri nje qendrim "tejkalimi" qe i karakterizonte Templaret. [...] Sipas ketij kuptimi, ajo cka kishte me te vertete rendesi nuk ishte nje deklarim i besimit, por aftesia e thjeshte per te kthyer luften ne nje pergatitje asketike per arritjen e pavdekshmerise."

Per me teper, aftesia e Gjergj Kastriotit si ushtar skllav, arratisja e tij dhe rikthimi i tij si Lord i Shqiperise ka paralele me menyren se si zgjidhej Mbreti i Nemit. Ne antikitet, sklleverit e arratisur shkonin ne pyllin e Nemit, afer Alba Longas (prane Romes), tek tempulli i perendeshes Diana per te luftuar Rex Nemorensis, dhe nese fitonte, ish-skllavi kurorezohej si Mbreti i Ri i Nemit. Prifti- mbret merrte nen posedimin dhe kujdesin e tij pemen e shenjte te Dianes dhe luftonte konkurrentet. Pemet dhe grate kane lidhje metaforike ne legjende. Mamaja e Skenderbeut, qe Skenderbeu e takon sapo kthehet ne Kruje, mund te konsiderohet si nje aluzion ndaj pemes se shenjte. Renegati shqiptar Ballaban Pasha eshte nje personazh qe luan rolin e sfiduesit ne paralelin e ritualit te rex nemorensis. Ai del vullnetar per tu bere kampioni i Sulltanit per te perballur me Skenderbeun ne pyllin ku ai ka vene kampin e ushtrise se tij. Episodi ku Skenderbeu perplaset me Ballabanin fillon me vallen luftetare te shqiptareve. Kjo praktike duket dhe tek miti antik i Kureteve, ku keto perendi te vockla perplasnin shtizat tek mburojat dhe kercenin per te fshehur Zeusin femije.

Beteja me Ballabanin ndodh ne pyll dhe Skenderbeu ne fillim dominohet nga armiku i tij. Ai bie ne toke, por rekuperon pasi mbahet tek nje peme, e cila ndonjehere pershkruhet si lisi, per tu ngritur ne kembe perseri perpara se te mposhte Ballabanin.

Cfare ia vlen te permendet ketu eshte qe ne momentin qe Skenderbeu prek lisin, ai rifiton forcen e tij. Lisi eshte pema e shenjte e Baba Qiellit dhe Bubullimesit dhe Skenderbeu paraqitet si nje kampion i kesaj perendie. Ballabani do te behet pashai i Shqiperise ne perralle, dhe do te zevendesoje sundimin e Skenderbeut ashtu sic ndodh ne ritualin e mbretit te Nemit. Sipas disa autoreve, nje menyre e tille seleksionimi mund te jete praktikuar ne Dodone, por nuk eshte e sigurt. Ama, prania e nje lisi te shenjte permendet ne Dodone.

Legjenda me e njohur mesjetare, ajo e mbretit Artur, dhe legjenda e Skenderbeut kane tematika te paralele mitologjike. Njera qe ia vlen te permendet eshte beteja mes Skenderbeut dhe famekeqit Hamza Kastrioti. Beteja mes Skenderbeut dhe nipit te tij Hamza ka paralele me dyluftimin mes Mbretit Artur dhe nipit te tij Mordred. Paralele te tjera gjenden edhe ne traditat e tjera arjane: lufta dinastike e Arjunes me familjen e tij ne traditen Vedike, Centurioni romak qe gabimisht denon birin e tij me vdekje. Thuhet edhe qe mbreterit e Shqeheve, kur beheshin shume pleq, luftonin pasardhesin e tyre gjer ne vdekje.

Per me teper, nje tufe mitesh per Skenderbeun flasin per shpaten e tij, nje shpate magjike qe vetem ai mund ta ngreje. Kjo ka paralele me shpaten e mbretit Artur, Excaliburin. Shpata i cohet Sulltanit si dhurate dhe ai ia kthen pas Skenderbeut, pasi as ai, as ushtaret e tij nuk e ngrene dot. Me te cahen male ne dysh, dhe i vetmi person tjetër qe e ngre ate shpate eshte mamaja e Skenderbeut qe ka vete gjak mbreteror.

Te ngresh shpaten mbi supe eshte nje shenje force Herkuleane, dhe na kujton mitin ku Herkuli merr vendin e gjigandit Atlas per te mbajtur boten mbi supe. Zoterimi i shpates eshte zoterimi i Axis Mundi, boshti i botes. Exkalibur i ngulur ne shkemb ka te njejtin kuptim si boshti i botes qe pret heroin e duhur per ta mjeshteruar. Imazhi i Excaliburit ne shkemb na kujton lisen e shenjte te Dodones, per shkak se pemet perfaqesojne boshtin ose boshtet e botes. Krahasimi me Excaliburin eshte me i thelle, pasi Jean Gagé shpjegon qe lisi i shenjte i Dodones i ka gjithasthu rrenjet ne nje shkemb.

Per me teper, kemi permendur hyjnine e larte shqiptare Enji, i lidhur etimologjikisht me zotin vedik Agni. Dita e Enjit eshte e Enjtja, qe e ben te ngjashem me Jupiterin (Giove ne italisht, dita e tij e enjte Giovedi). Nga ana tjetër, ngjashmeria e tij me Agnin na ben te mendojme qe kishin funksione te ngjashme. Vetetima eshte zjarr ne qiell, Enji mund te perfshije ne vete Zeus/Jupiterin dhe Agnin, por ky i fundit ka elemente te tjera interesante per te shtuar. Agni perfaqeson tre kastat e tripartimit Indo Evropian: ai

eshte nje zot prifteror, nje zot luftetar dhe posedon dhe jep jeten, qe e lidh me prodhuesit. Agni quhet ndonjehere Vanaspati, qe do te thote zoti i pemeve. Kjo perforcon lidhjen mes lisit te shenjte te Dodones, Zeusit dhe ekuivalentit te mundshem shqiptar Enji.

Kjo lidhje thuaj na jep pershtypjen e nje binjakezimi mes Dodones dhe Shqiperise, ku mali Tomarus eshte binjaku etimologjik i malit Tomorr, me te ciin qyteti antik ilir i Albanopolis i permendur nga Ptolemeu dhe qendra tradicionale e Dodones jane shpirterisht, edhe pse jo gjeografikisht, i njejti vend, dhe ku Jupiteri dhe Enji jane hyjni qe sundojne mbi pemet e shenjta dhe kane shqiponja si simbol. Ngjashmerite shkojne edhe me tej kur Pirro konsiderohet si kampioni i Dodones gjate antikitetit, ashtu si Skenderbeu ne mesjete.

Jean Gagé permend faktin qe Dodona ka nje burim uji afer pemes se lisit, dhe qe mbreterit e shenjte te saj komandonin lumenjte me kembet e tyre. Nje variant i ketij koncepti eshte gishti i kembes se Pirros se Epirit qe thuhet qe kishte fuqi sheruese, kurse beteja e Akilit me lumin Skamander (ku ai shpetohet nga Hefesti, zoti grek i zjarrit) dhe dobesia e tij ne thember jane inversione te kesaj tematike. Ne rastin e Skenderbeut, ai thuhet te kete ndalur lumin Drin me kemben e tij qe te lejonte ushtrine e tij te kalonte, dhe krijoi keshtu nje permbytje qe mbyti armiqte e tij. Per me teper, kockat e marra te Skenederbeut dhe perdorimi i tyre si talizmane pamposhtmerie kane nje paralel me mbajtjen e gishtit sherues te kembes se Pirros si relike pasi i dogjen trupin. Me shume se sa nje

kopje e nje teme Biblike, kjo e ben Skenderbeun mbret te shenjte te Dodones dhe trashegimtar te nje tradite antike.

Ky trend ezoterik ne legjenden e Skenderbeut eshte nje e dhene ndaj nje etosi heroik tejet indo-evropian. Popullariteti i Skenderbeut ne Evrope nuk eshte per tu habitur, duke pare se si temat e tij mitike te njohura ne boteveshtrimin indo evropian. Shqiperia dhe me sakte tradita e saj duket te kene ruajtur shume prej ketyre karakteristikave indo evropiane ne legjendat per heroin tone.



# Skenderbeu, perandori i shenjte

**T**ematikat imperiale ne legjendat e Skenderbeut jane nje lidhje e vazhdueshme qe shkon pertej legjendes dhe ka rrenje ne realitet, nje shembull i qarte i forcave superiore qe veprojne ne momente te favorshme historike dhe rezultojne ne shkrirjen e realitetit me simbolizmin dhe me simbolizmin qe behet realitet. Me tematike imperiale ne nenkuptojme elementet e lidhura me simbolet me te larta te realizimit metafizik, shpesh te atribuara ne shkallen me te larte te sovranitetit, duke bashkuar forcat shpirterore dhe temporale. Kjo ishte qendra rreth te ciles rrotulloheshin legjendat e Graalit, nje produkt i idese imperiale Ghibeline qe ishte permbajtesja e spiritualitetit Tradicional gjate periudhes mesjetare sipas Julius Evola.

Boteveshtrimi Ghibelin ishte ne kundërshtim me ate te Guelfeve: te paret shikonin Perandorin si autoritetin me te larte, kurse te dytet shikonin Papen. Per te shpjeguar perse kundërshtimet degjeneruan ne luftera te hidhura mes Papatit dhe Perandorise se Shenjte Romake duhen pare dhe elemente te tjera, si per shembull Perandori mendohej te kishte nje karizma te shenjte qe bashkonte temporalen me shpirteroren dhe konflikti per ceshtjen e nje force

internacionaliste (Papati) qe denonte dhe impononte deshiren e tij mbi provincat e ndryshme kundrejt nje force supranacionale (Perandoria) qe respektonte traditat e ndryshme brenda vetes, por i bashkonte drejt nje drejtimi vertikal.

Gjithsesi, literatura Ghibeline eshte shume e pasur, sidomos ne simbolike. Dhe fakti qe legjenda e Skenderbeut u zhvillua gjate renies se Perandorise Romake te Lindjes (Bizantit) shton paralelet mes tij dhe Ghibelineve.

Duke u zgjeruar tek tema e dualitetit e gjetur tek briret e helmetes ose dy kokave te shqiponjes qe perfaqesojne zoterimin mbi temporalen dhe shpirteroren, dy shpatat e Skenderbeut jane manifestime te nje simboli te gjetur ne literaturen Ghibeline si nje metafore te Perandorit te shenjte qe ribashkon fuqite temporale dhe shpirterore dhe sundon mbi nje perandori. Kjo teme eshte e zakonshme ne legjendat e Graalit ku i zgjedhuri duhet te marre si fillim fuqine temporale (shpata e pare) perpara se te iniciohet ne zbulimet hyjnore (shpata e dyte). Nje variant i kesaj teme perfshin shpaten e thyer ne dy pjese qe heroi duhet ta farketoje nga e para. Ashtu sic ka thene Julius Evola ne punen e tij Misteri i Graalit, epoka mesjetare po priste per nje figure te tille te merrte dinjitetin temporal dhe shpirteror, dhe miti i Graalit flet per nje personazh te tille qe rikthen rendin Tradicional. Skenderbeu ishte nje personazh i tille, dhe dy shpatat jane nje nga provat e shumta per kete. Dicka qe ia vlen te permendet ketu eshte prania e gjakut tek nje nga shpatat. Edhe pse kjo nuk permendet para shekullit te 19,

prania e gjakut eshte paralele me shtizen e pergjakur tek miti i Graalit.

Per me teper, simbolizmi i shpates ka te beje me boshtin e botes. Ne traditat Indo Evropiane, kur boshti i botes simbolizohet nga nje arme, eshte gjithnje nje arme duale, si vajra (lexohet vaxhra) Indiane. E njejta gje vlen edhe per shpatat e Skenderbeut: njera eshte per shkaterrim, tjetra per mirembajtje. Ky aspekt ka te beje me simbolizmin e rrufeve dhe rrezeve te diellit. Rrezja e diellit, ashtu si rrufeja, mund te jete vdekjeprures ose te kete fuqi sheruese. Shtizat e Indras, Apollonit dhe Akilit dhe shtiza e pergjakur e Graalit kane te gjitha fuqi duale. Shpata e Skenderbeut ka fuqi sheruese; duke prekur nje gur me majen e shpates, nje burim uji me fuqi sheruese del nga mali per ushrine e tij. Por potencialet antagoniste na kujtojne natyren e brendshme te te dyja shpatave, si dy fundet e te njejtit bosht. Pra, nuk eshte per tu habitur qe miti i Skenderbeut permend me se shumti vetem nje shpate: sipas doktrines Tradicionale dy shpatat jane shkrire ne nje te vetme.

Ne fushen shpirterore, te besh mrekullira eshte nje indikim qe dikush eshte mbret i shenjte. E permendem me pare mrekulline e ujit, por nje tjetër indikim gjendet tek bekimet. Gjergj Kastrioti eshte ne gjendje te mallkoje rraca dhe fise te tera. Ai eshte edhe ne gjendje te ktheje thesaret e kapura nga armiku ne gure duke i mallkuar. Nga ana tjetër, bekimet e tij jane me te vlefshme se bekimet e nje shenjtori. Nje e dhene tjetër jepet nga boteveshtrimi

indo evropian qe lidh legjislacionet me kasten prifterore. Pra, Romuli dhe pasardhesi i tij Numa kuptohen si dy anet e te njejtës monedhe: njeri vendos ligje dhe tjetri ka fuqi hyjnore. Fakti qe Skenderbeu njihet per Kanunin e Skenderbeut mund te jete nje pasqyrim i kesaj zotesie shpirtërore.

Eshte interesante qe Skenderbeu lindi ne ditën e Shen Gjergjit; dite gjate te ciles shqiptaret - duke ndjekur me siguri nje rit prekristian - bejne kurban dele per te festuar ardhjen e pranveres. Shqiptaret bejne pelegrinazh ne kete dite ne nje shpelle ku thuhet te kete ndodhur beteja mes Shen Gjergjit dhe dragoit. Nje perralle thote qe Skenderbeu lindi ne nje shpelle, dhe kjo gje pervecse e lidh me lindjen e Zeusit, mund te jete origjina e pelegrinazhit ne ditën e Shen Gjergjit. Pa u thelluar shume ketu, shpella simbolizon dijet ezoterike (kurse mali ato ekzoterike), dhe vetem nje i iniciuar mund te dale nga ajo, dhe nuk eshte habi qe shpellat ishin me shume rendesi ne kultin Mitraik. . Per me teper, Shen Gjergji eshte ekuivalenti kristian i perendive pagane te vetetimes, qe pavaresisht ndryshimeve te vogla nga populli ne popull, ishin pergjithesisht perendite e kastes luftetare. Nuk eshte e pamundur qe pas vdekjes se heroit, keto sakrifica beheshin te nderonin vete Skenderbeun, sidomos kur merren parasysht vetite shpirtërore te lidhura me te.

Ne planin temporal, udheheqja e Skenderbeut dhe Lidhja e Lezhës kane te gjitha karakteristikat e nocionit tradicional te Perandorise. Senati romak, qe pershkruhej si nje mbledhje

mbreterish ka gjithashtu paralele me Lidhjen e Lezhes. Mbledhja e kryezotave shqiptare qe e shihnin njeri tjetrin si te barabarte, per te zgjedhur nje lider eshte paralele me menyren se si Perandoria e Shenjte Romake zgjidhte Perandorin. Fakti qe Lidhja zgjodhi Skenderbeutn si udheheqes duhet pare ne perspektiven e sakte: Skenderbeu u zgjodh pasi kishte karizma te shenjte dhe fuqi shpirterore. Ashtu si mbreti Artur u be mbret pasi terhoqi Excaliburin nga guri.

Fakti qe cdo anetar i Lidhjes kishte autonomi ne tokat e tij perputhet me organizimin e Perandorise ne mendimin politik Ghibelin. Perandori i shenjte eshte lideri i shenjte i Perandorise dhe e orienton ne menyre vertikale sepse ai eshte ura me forcat me te larta, por nuk nderhyn ne politikat e brendshme vetjake te lordeve nen vete. Roli i Skenderbeut si koka e Lidhjes ishte i ngjashem me rolin e Perandorit te shenjte. Mund te biem ne perfundimin qe Skenderbeu, duke organizuar Lidhjen sipas principeve te Tradites dhe duke terhequr dhe lorde te huaj deri edhe nga Anglia, ishte kreu i nje Mannerbundi te shenjte, nje shoqeri burrash fisnike, baza e Qeverive te denja dhe paralel me ate cka thame per ver sacrum.

Por menyra se si u organizua Lidhja nuk u shpik nga Skenderbeu, por ishte e zakonshme per te gjithë Ballkanin. Qytet-shtetet antike greke jane shembuj te mirenjohur, por praktikat e Maqedonise, Epirit dhe Ilirise duhen marre parasysh ketu. Edhe pse ato qeveriseshin nga mbreter, keto kombe perbeheshin ne fakt

nga mbreter ose lorde te vegjel autonome, te cilet ishin aleatet e Shtetit. Mbreti me i larte, sidomos ne Iliri dhe Epir duhet te fitonte ne fushebeteje - eshte mantifestimi i mandatit hyjnor dhe i mbreterimit te shenjte - perndryshe, ai hiqet qafe dhe lordet e vegjel vene dike tjeter ne krye i cili tregon karizma hyjnore. Linja e vazhdueshme e doktrinave metafizike tradicionale te Ballkanit antik mbi mbreterit e shenjte rishfaqet shekuj me vone me Skenderbeun, e simbolizuar nga briret e helmetes dhe nga Lidhja qe ai udheheq sipas modelit Epirot dhe Ilir.

Pretendimet perandorake te Skenderbeut permblidhen ne nje vule qe e pershkruan si perandor te gjithe Ballkanit, edhe te turqve. Keto pretendime mbeshteten nga mandati hyjnor qe shkelqen permes auctoritas dhe imperium te tij. Sic thame me pare, titulli i tij Athleta Christi eshte nje reduktim i dhenies se fitoreve nga direkt hyjnorja. Mrekullite e Skenderbeut, adhurimi i tij nga populli, dhe sukseset e tij ushtarake jane prova qe ai ishte nje reflektim i perandorit te shumepritur, qe merr fuqi temporale dhe shpirterore, te gjetura ne mitet Ghibeline, por kesaj rradhe ne kontekstin e renies se Bizantit.

# Vdekja e Skenderbeut

**T**ani duhet te flasim per vdekjen e heroit. Pika e takimit mes jetes dhe vdekjes eshte nje teme nga e cila kane lindur shume legjenda. Nje nga legjendat me te vjetra tregon se si Skenderbeu takohet me vete Vdekjen. Ai guxon te nxjerre shpaten dhe perpiqet ta luftoje. Me vone, ai i thote trashegimtarit te tij te shkoje ne breg te detit dhe te gjeje nje peme selvie, dhe aty te lidhe kalin, flamurin dhe shpaten e tij. Pervec ngjashmerise me legjenden e kthimit te shpates Excalibur ne liqen nga Bediveri nen urdherat e mbretit Artur, dy elemente te tjera na terheqin vemendjen.

Se pari, gjejme perseri motivin perandorak Ghibelin te lidhur me Skenderbeun. Ashtu si shpjegon Julius Evola, vetem kur Perandori i shumepritur (pasi te kete marre fuqi materiale dhe shpirterore) e var mburojen tek nje peme e thate, ajo peme do te cele lule perseri. Ky imazh sherben per te shprehur rikthimin e Tradites si parakusht i fillimit te nje Epoke te Arte.

Perandori qe merr persiper kete veprim ringjalles shpesh identifikohet si Perandori qe Fle. Pergjithesisht, ai identifikohet me nje personazh historik (si psh Frederik Barbarosa apo Konstandini XI). Perandori i ka shpetuar vdekjes dhe do te rikthehet ne fund te Kali Yuga-s/Epokes se Erret. Sipas

folkloristit grek Nikolaos Politis, Shqiptaret ende besonin se Skenderbeu do te rikthehej t'i udhehiqte, te rimerrte mbreterine dhe ta hiqte qafe Sulltanin njehere e pergjithmone. Sepse per ta Skenderbeu nuk vdiq, por pret duke fjetur ne nje mal. Kjo miteme ka te beje dhe me ardhjen e Avatarit te Fundit te Zotit Vishnu, Kalki, dhe ketu roli i Skenderbeut eshte i ngjashem me avatarin Kalki mbi kalin e tij te bardhe.

Por per te merituar nje privilegj te tille, tre kushte duhet te permbushen: shqiptaret e vertete duhet te organizojne nje revolucion kunder Sulltanit, te mos keqtrajtojne grate dhe te mos thyejne kurre besen. Kushti i dyte lidh konceptin shqiptar te gruas me konceptin e dashurise se sjellshme te oborreve te Evropes mesjetare (dhe ketu duhet te kujtojme rolin e femrave ne legjenden e Graalit), dhe kushti i fundit duhet te kuptohet si nje lloj fides metafizik. Kushti i pare eshte disi i turbullt, por pergjigja qe iu dha folkloristit grek Politis kur ai tha se shqiptaret nuk mund ta ndjekin Skenderbeun pasi jane muslimane eshte si vijon: "Ne u konvertuam per te mos paguar taksa. Jemi te sigurt qe Skenderbeu do t'i kuptoje arsyet tona.". Pra, tre kushtet jane ne fakt simbolike: te mos keqtrajtossh gruan eshte te mos keqtrajtossh dijen (gnosis), nje revolucion kunder Sulltanit nga shqiptare te vertete do te thote braktisja e fese se Sulltanit, dhe te mbash besen eshte te mbash ne mendje heroin tone dhe mesimet qe ai na dha ne momentet e fundit.



Keshilla e fundit e Skenderbeut per shqiptaret ishte te qendronin te bashkuar, dhe si shembull ai perdori nje tufe shkopinjsh druri qe jane te pathyeshem kur lidhen bashke. Edhe pse kjo eshte nje alegori e zakonshme per bashkesine ne Evrope, fakti qe kjo tufe shkopinjsh ngjan me fasces Romake duhet te na beje te konsiderojme simbolizmin ketu. Shkopinjte prej druri zakonisht lidhen rreth nje sepate. Sepata eshte nje simbol polar stabiliteti dhe principi fuqie, qe eshte arsyeja pse shkopinjte prej druri rrotullohen rreth saj. Ne fasces-in e Skenderbeut nuk ka nje qender rreth te ciles bashkohen shkopinjte. Ne fjale te tjera, simboli qe i lidh ato eshte i fshehur, pra kemi te bejme me nje princip ezoterik. Ky princip ezoterik ne qender ka te beje me ezotericizmin e Skenderbeut.

Elementi i dyte qe ia vlen te permendet ka te beje me pemen e zgjedhur nga Skenderbeu: selvia. Ne Antikitete ishte simbol pavdekshmerie. Kombinimi i simboleve mbreterore te Skenderbeut me selvine i ben ato te pavdekshme.

Pra Skenderbeu ne momentin e vdekjes kalon ne nje process hyjnizimi, ashtu si Perandoret Romake dhe heronj te tjere mitike. Jehona me e madhe e Tradites Indo-Evropiane eshte qe peripecite e tij i hapen rrugen drejt hyjnores: ai e fitoi ate me shpate, si nje kshatriya (emri i kastes luftetare arjane) i vertete. Rrefenja te mevoneshme mbi plackitjen e varrit te tij nga ushtar te turq ne menyre qe ata te benin relike pamposhtmerie me kockat e tij jane deformime te idese se hyjnizimit.

Nje element tjeter qe ia vlen te diskutohet eshte kombinimi i shpates me selvine: te dy simbole te boshtit te botes sic kemi shpjeguar me lart. Boshti i botes gjendet ne qendren e botes, qendrat tradicionale konsiderohen si qendra te tilla. Dodona dhe Delfi jane shembuj te mirenjohur te tradites qe tregojne nje bosht simbolik: lisi dhe omfalosi. Shqiptaret thuhet te jene lutur duke u drejtuar drejt varrit bosh te Skenderbeut ne shek. e 19. Te lutesh drejt nje vendi eshte ta njohesh si qender tradite. Fakti qe vetem shpata e Gjergjit u gjet ne varr duhet te kete shkaktuar lutje te orientuara drejt varrit bosh. Ne fakt, varret bosh shpesh jane shenje e nje vendi inicimi, si per shembull varri ne Extersteine, ku mendohet te kete qene Yggdrasil, pema-bosht sipas tradites gjermanike.

Duke risjelle dhe mbrojtur Traditen e tij, Skenderbeu arriti te merrte perjetesine. Duke e ngritur veten ne nje status hyjnor, rryma ezoterike e epikes se tij e le rrugen Indo-Evropiane drejt hyjnores te hapur per shqiptare e denje per emrin qe kane.

# Perfundimi

"Te ekzistosh do te thote te luftosh kunder  
cdo gjeje qe te kercenon."

-Dominique Venner-

Ka ardhur koha te permbyllim studimin tone te simboleve dhe legjendes se Skenderbeut permes metodes Tradicionale. Duke rishikuar simbolet e tij (flamuri, helmeta, shpata) dhe duke theksuar lidhjet e tyre te thella logjike, i kemi lidhur me nje kuptim shume me te larte dhe antik. Sot e kesaj dite, per shkak te degjenerimit, pak simbole kane domethenie tradicionale. Nga ana tjetere, simbolet e Skenderbeut, duke qene unike, permbajne ende nje udhe shpirterore te paster per shqiptaret e denje; nje udhe shpirterore qe perfshin si institutin Ilir te Dodones ashtu edhe boteveshtrimin Indo-Evropian.

Qe nga ngjyrat e flamurit (te njejta me ngjyrat e shenjta te Indo Evropianeve) deri tek helmeta (simbol i Aegisit qe jep pamposhtmeri dhe zoterim ndaj rrufese), cka eshte e fshehur tek ezoterizmi i Skenderbeut eshte shprehje shqiptare e Tradites.

Skenderbeu ka shume te perbashketa me mbreterit e shenjte antike te Dodones; si Skenderbeu ashtu edhe ata, luftuan per mbrojtjen e tradites se Dodones, dhe vete Skenderbeu eshte mbreti i shenjte i tradites shqiptare. Ne fakt, autori japonez Yukio Mishima ka shpjeguar ne tekstin e tij Mbrojtja e kultures, qe nese do te mbrosh nje kulture, duhet te kesh nje identifikim absolut te asaj cka duhet mbrojtur dhe te mbrojtjesve te saj. Kjo thenie i pershtatet me se miri Skenderbeut dhe identifikimit te tij total me kulturen dhe traditen qe ai mbrojti me cdo kusht. Toka e Shqiperise, duke mbajtur emrin e nje qendre tradicionale, eshte e shenjte. Dhe ashtu si veprat e Akilit u kenduan nga Homeri, ashtu edhe shqiptaret do kendojne per Skenderbeun pergjithmone, nje kusht per te arritur pavdekshmerine sipas tradites Indo Evropiane shqiptare.

Mishima shton se mbrojtja eshte nje renovim dhe ne te njejten kohe krijim dhe e ardhme. Skenderbeu e arriti tamam kete pavaresisht rrezikut te madh. Ai rinovoi traditat antike, duke i shprehur ne nje menyre specifikisht shqiptare, dhe duke i dhene nje te ardhme duke qene ylli polar per ata te afte te tejkalojne materialen dhe te ndjekin rrugen e tij. Ai eshte ura jone metafizike, ndoshta e fundit, drejt nje boteveshtrimi indo-evropian, dhe drejt Epokes se ardhme te Arte evropiane, pjese e te ciles jemi dhe ne dhe qe na pret ne ditën e rikthimit te tij. Por ka kushte per rikthimin, ashtu si ka kushte per te arritur Graalin.

Permes legjendes se Gjergj Kastriotit, ne behemi deshmitare te menyres se si vepron tradita luftarake Indo Evropiane, e vetmja e pershtatshme per shqiptaret. Duke tejkaluar devotshmerine ekzoterike te monoteizmave, kjo Tradite burrerore, diellore dhe shpirterore na ofron te arrijme ne kete jete ate cka eshte me shume se jeta. Lavdia e Skenderbeut ne fushebeteje dhe mitet qe e rrethojne ate jane nje jehone e arritjeve ne nje plan me te larte. Ky eshte drejtimi nga duhet t'i drejtojne syte shqiptaret, sepse zgjidhja ndaj situates se tanishme gjendet tek vete Tradita jone, nje pjese unike e Tradites Indo Evropiane

Skenderbeu ka qene nje nga luftetaret e fundit Evropiane qe hapi rrugen drejt nje ekzistence hyjnore, pa ndihmen e ndonje feje te organizuar. Dhe si i tille, shembulli qe vuri eshte me rendesi paresore, i ngjashem me ate te heronjve te Antikitetit. Sidomos per shqiptaret, nga gjeniu i te cileve buruan mitet mbi Skenderbeun, ky eshte nje veshtrim i qarte si kristal ne boteveshtrimin e tyre shpirteror. Dhe Skenderbeu eshte nje manifestim fizik i Heroit arketipik Shqiptar, nje avatar i hyjnores lindur ne nje kohe kur populli i tij ishte ne rrezik te madh.

Skenderbeu eshte mishkrimi shqiptar i Tradites. Le te kujtojme se simboli i tij me karakteristik – shqiponja e zeze dykrenare – qendron si nje evokim i mitit te Dodones. Dhe ashtu si Dodona ishte qender e Tradites, ashtu eshte dhe Skenderbeu: qendra e Tradites shqiptare.

*"Every man bears a tradition that makes him what he is. Tradition is a choice, a whispering from both ancient times and future. It tells me where I come from."*

Dominique Venner, *Le Coeur  
Rebelle*

# Foreword

This work is the result of a feeling of urgency. In a modern world that continues to lose touch with the higher realities of eternal truths, to seek easy consolation and avoid any responsibilities, preferring the life of a slave rather than that of a lion for it may end abruptly, it is no surprise that a character like Skanderbeg disturbs our contemporaries. From so called Albanians gesturing their hands in the shape of an eagle and forgetting about the rest, to those schizophrenics going so far as to reject him as their hero (having thus only the language in common with Albanians worthy of the name), to politicians that should meditate upon the significance of Skanderbeg's gift to the Albanian renegade Ballaban Pasha: a wooden stick to remind him that he has no right to lead men, to those having Stockholm's syndrome and promoting eternal friendship with their father of the nation's sworn enemies. What is important is not the current diplomatic situation in the Balkan peninsula. What matters is to distinguish in history the metaphysical trends represented by each nation and empire, to be aware of where one stands in relation to them and where one ought to stand. In other words, it's about fitting inside one's Tradition.

There is a need for the Albanian culture to adopt a Traditional reading of Gjergj Kastriot Skanderbeg's epic. Indeed, without a

firm point of reference, a polar star, our culture can only drift endlessly. Only Gjergj Kastriot Skanderbeg could offer us true Albanians this unshakable point. The present work is a modest collection of articles that tries to provide such a point of reference. The articles have been published online from October 2019 to January 2020, and they have been worked anew to fit better together here. They are the product of patriots belonging to another time, fed up with the corruption of the modern world but willing to accomplish their destiny and duty as Albanians nonetheless. This study of Skanderbeg's esotericism is also the result of an intellectual intuition that has proven itself very helpful.

We hope that this work will provide a basis for further traditional investigations revolving around our hero and may trigger other traditional studies dealing with our Illyrian heritage, medieval Albania, or with our highlanders' worldview. The traditionalist understanding of Skanderbeg's esotericism may act as a refreshing fountain for our identity: the combination of our longest and deepest European ancestral memory with our very own mythic expression centred around our hero reflecting the Perennial Tradition. Indeed, when the fitting traditional sources of a people are correctly summoned, new salutary political perspectives could emerge within those leading such investigations, and Albania and Albanians could taste the return of a golden age that should include Europe as well.



Such a quest, very similar to the Grail's quest, in order to regain what appears as irremediably lost can only begin through Gjergj Kastriot Skanderbeg, and only with his help could one undertake it in the first place. No doubt that unknown friends from the other side of the river that separates our physical profane world from the Gods' metaphysical realm will come to our help.

This work is dedicated to all Albanians still worthy of the name, living in the fatherland or abroad. It is also dedicated to the memory and spirit of our national hero Gjergj Kastrioti Skanderbeg.

# Introduction

“Only the return of the Traditional spirit could save Europe.”

-Julius Evola-

- Albania and Tradition

